

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5453  
E martë, 17 prill 2018  
çmimi 0.40 €

## Kuvendi nuk e themelon komisionin për të dëbuarit turq

Në seancën e Kuvendit të Kosovës të hënën u propozua që në rend dite të hyjë themelimi i Komisionit Hetimor Parlamentar për deportimin e gjashtë shtetasve turq, por një gjë e tillë nuk u bë pasi deputetët refuzuan të marrin pjesë në votim



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", MIMOZA AHMETAJ ■ FAQE 4-5

## Kosova duhet ta avancojë procesin e integritimit

Ish-ministrja e Integritimit Evropian, Mimoza Ahmetaj, ka thënë se Raporti i Progresit do t'i evidentojë të arriturat dhe sfidat që e presin Kosovën. Ajo ka theksuar se në këtë raport do të kërkohej angazhim nga secili institucion për ta implementuar agjendën evropiane. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Ahmetaj ka pohuar se Kosova duhet ta vazhdojë luftimin e krimit dhe korrupsionit, reformat në

drejtësi, si dhe reformat në administratën publike. Sipas saj, fokus kryesor i institucioneve duhet të jetë avancimi i procesit integruar. Ahmetaj ka vlerësuar se demarkacioni me Malin e Zi ka qenë mësim për të gjithë se sa i rëndësishëm është konsensusi politik në agjendën evropiane. Ajo ka shprehur optimizëm se gjatë këtij viti qytetarët e Kosovës do të lëvizin pa viza në vendet e BE-së



## AKTUALE

### RREZIKU NGA SHPRISHJA E POLITIKËS DHE NEVOJA PËR RIKTHIM DREJT MORALIT



Dr. Sabri KİÇMARI

### KURTI I THOTË AMBASADORIT ITALIAN SE VENDI DUHET TË SHKOJË NË ZGJEDHJE TË REJA

### HAPET KONKURSI PËR POLICË TË RINJ

## EKONOMI

### MINISTRI HASANI MERR MASA MBROJTËSE PËR QUMËSHIN

### EDHE 12 OBJEKTE PUBLIKE BËHEN ME MASA TË EFIÇIENCËS SË ENERGJISË

## KULTURË

### KUR DHEMBJA E INDIVIDIT BËHET FRYMË E QËNDRESËS KOMBËTARE

Prof. dr. Emin KABASHI

## SPORT

### REXHAJ: BESA NUK LARGOHEJ NGA SUPERLIGA

### BIRAJ: REZULTATET NË LIGËN BALLKANIKE, HISTORIKE



KRYEMINISTRI I BULLGARISË, BOYKO BORISSOV, PO QËNDRON PËR VIZITË ZYRTARE NË KOSOVË ■ FAQE 3

## Borrisovi: Kosova do të përfaqësohet në Samitin e BE-së në Sofje

Kryeministri i Bullgarisë, Boyko Borissov, ka bërë me dije se Kosova do të përfaqësohet në Samitin e BE-së në Sofje, i cili do të mbahet më 16 dhe 17 maj. Teksa ka ftuar presidentin Hashim Thaçi të marrë pjesë në këtë samit, kryeministri bullgar ka thënë se Republika e Kosovës në këtë rast do të përfaqësohet ashtu siç e kanë njohur mbi 100 shtete

## Behgjet Pacolli nderohet me titullin 'Qytetar Nderi i Kukësit'

Me rastin e shënimit të 19-vjetorit të eksodit kosovar në Kukës, zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, është nderuar me titujt

"Qytetar Nderi i Kukësit" dhe "Nderi i Qarkut Kukës" për kontributin e dhënë në mbështetje të luftës çlirimtare dhe të kampeve të bashkëkombësve të larguar nga lufta ■ FAQE 7



**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Çarëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009; +389 44 487 755; +389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk); Mob: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Prizren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Mob.: +377(0) 44 506 815  
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030  
e-mail: [sat\\_styro@yahoo.com](mailto:sat_styro@yahoo.com)  
[www.satstyro.com](http://www.satstyro.com)

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Rama: Të punojmë sikur zgjedhjet të jenë këtë qershor

**TIRANË, 16 PRILL** - Kryetari i Partisë Socialiste, Edi Rama, nuk është i kënaqur me punën që është bërë deri tani nga deputetët dhe strukturat e partisë nëpër rrethe.

Gjatë mbledhjes me grupin e deputetëve që ka pasur të

hënën, Rama u ka kërkuar deputetëve të dalin në terren dhe të punojnë për zgjedhjet lokale të 2019-s. "Të punohet më shumë me bazën. Të shpërndaheni nëpër zonat tuaja. Drejtuesit e degëve në rrethe të jenë të përkushtuar. Angazhimi në terren duhet

të jetë maksimal. Të punojmë sikur zgjedhjet të jenë këtë qershor", mësohet të ketë thënë Rama në mbledhjen me dyer të mbyllura. Po ashtu, kryeministri Edi Rama ka folur edhe për seancën e ditës së enjte në Kuvend, ku u shoqërua me

tensione dhe përplasje të forta. Ai u ka kërkuar deputetëve ta ruajnë qetësinë dhe të mos bien pre e provokimeve të opozitës. "Nuk duhet t'u kundërpërgjigjemi provokimeve të opozitës", është shprehur Rama.



Milo Gjukanoviçi është zgjedhur president i Malit të Zi

# Gjukanoviçi: Jemi në rrugën e duhur dhe drejt anëtarësimit të vendit në BE

Duke falënderuar qytetarët që e votuan, ata që morën pjesë në zgjedhje dhe aleatët që e mbështetën, mes të cilëve edhe shqiptarët, Gjukanoviçi ka thënë se rezultati i qartë tregon se vizioni dhe programi i tij në krye të Malit të Zi është i duhuri

**PODGORICË, 16 PRILL** - Qendra për Qendra për Monitorim dhe Kërkim (CeMI) ka njoftuar se politikanin properëndimor malazias, Milo Gjukanoviçi, ka fituar 53.5 për qind të votave në zgjedhjet presidenciale të së dielës. Ndërsa Miladen Bojaniçi, një afarist i mbështetur nga një aleancë e partive opozitare, përfshirë edhe disa që dëshirojnë lidhje më të ngushta me Rusinë, radhitet i dyti me 34 për qind të votave.

Në fjalimin e tij pas fitores, Gjukanoviçi ka thënë se "ne jemi të pamposhtur"! Sipas tij, rezultati i qartë tregon se vizioni dhe programi i tij në krye të Malit të Zi është i duhuri.

"Konfirmohet se jemi në rrugën e duhur dhe drejt anëtarësimit të vendit në Bashkimin Evropian", tha ai.

Gjukanoviçi ka falënderuar qytetarët që e votuan, ata që morën pjesë në zgjedhje dhe aleatët që e mbështetën, mes të cilëve edhe shqiptarët, ndërsa përcolli edhe një mesazh për rivalët. "Rezultati tregon qartë dhe është një mundësi që të reflektoni e t'i

rishqyrtoni bindjet e tuaja. Asgjë nuk mund të arrihet politikisht duke mohuar gjithçka që Mali i Zi ka arritur deri më tani", tha ai në mesazhin e vet.

Zgjedhjet e së dielës janë të parat që kur vendi u bashkua me NATO-n në vitin 2017 dhe shihen si një provë për orientimin evropian të vendit.

Milo Gjukanoviçi dhe partia e tij drejtojnë për gati tridhjetë vjet vendin e vogël buzë Adriatikut, që shpall pavarësinë në vitin 2006.

Zgjedhjet parlamentare të vjeshtës së vitit 2016 kaluan nën hijen e arrestimeve të një grupi nacionalistësh serbë të dyshuar për përfshirje në një komplot për vrasjen e Milo Gjukanoviçit dhe vënien në pushtet të partive pro ruse, për ta penguar anëtarësimin e Malit të Zi në NATO.

### Thaçi dhe Haradinaj urojnë Gjukanoviçin për fitoren

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, përmes profilit të tij në



rrjetin social "Twitter", ka uruar presidentin e ri të Malit të Zi, Milo Gjukanoviçi. "Urime mikut tim të vjetër, Milo Gjukanoviçi, për fitoren e tij në Mal të Zi. Kjo është një fitore për Malin e Zi, por edhe për gjithë rajonin që aspiron integritetin në NATO dhe BE", ka shkruar ai Thaçi. Ai ka shkruar se pret rritje të bashkëpunimit ndërmjet dy popujve.

Edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka uruar qytetarët e Mali të Zi për zgjed-

hje të lira dhe demokratike presidenciale. Haradinaj ka thënë se Qeveria e Kosovës shpreh gatishmërinë për bashkëpunim dhe avancimin e marrëdhënieve të mira me Malin e Zi edhe në të ardhmen. "Urime qytetarëve të Malit të Zi për zgjedhjet e lira e demokratike presidenciale. Po ashtu, i uroj fitoren presidentit të zgjedhur, Milo Gjukanoviçi. Qeveria e Republikës së Kosovës shpreh gatishmërinë për bashkëpunimin dhe avancimin

e marrëdhënieve të mira me Republikën e Malit të Zi edhe në të ardhmen, në të mirë të të dy popujve tanë, për perspektivën euroatlantike!", ka shkruar Haradinaj në profilin e vet në "Facebook".

Presidentin malazias, Milo Gjukanoviçi, e ka uruar edhe presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta. Ai ka vlerësuar se fitorja e Gjukanoviçit është mbështetje e qartë për konsolidimin e orientimit euroatlantik dhe evropian të Malit të Zi.

## Basha kërkon nga CDU/CSU mbështetje për çeljen e negociatave

**TIRANË, 16 PRILL** - Kur mbeten edhe 24 orë nga momenti kur Komisioni Evropian do të vendosë t'i hapë ose jo rrugë çeljes së negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, nga Berlini, njofton se në emër të opozitës i ka kërkuar grupit qeverisës të udhëhequr nga kancelaria Merkel, CDU/CSU, ta hapë

dritën jeshile për Shqipërinë. "Sot kemi kërkuar, bashkë me Bylykbashin, që CDU/CSU ta pranojë hapjen e negociatave me Shqipërinë. Kemi kërkuar mbështetjen si një akt pranimit për çdo shqiptar. Si një përpjekje të shtuar për t'i plotësuar kriteret si lufta kundër krimit të organizuar, reforma në drejtësi si dhe respektimi i të drejtave të njeriut",

u shpreh Basha në një video live nga një takim pune në Berlin. "Në emër të PD kemi garantuar se duhet parë ky si një proces për ta çmontuar narkoshtetin, një problem jetik për Shqipërinë, për t'i vendosur të gjithë shqiptarët të barabartë para ligjit, për t'i arrestuar kriminelët, për ta çliruar ekonominë nga monopolet, për ta rikthyer konkurrencën si

parakusht për zhvillimin ekonomik", u shpreh Basha. Lideri i opozitës theksoi se "përmes hapjes së negociatave do të vazhdojë të shtojë betejën e opozitës për ta çliruar Shqipërinë nga krimi i organizuar dhe padrejtësia". Basha theksoi se takimi i parë në Bundestag ka qenë i suksesshëm dhe se ai dhe grupi i punës nga



PD-ja do t'i vazhdojnë takimet e tjera, natyrisht duke ndjekur me vëmendje të plotë zhvillimet në Shqipëri.

Kryeministri i Bullgarisë, Boyko Borissov, po qëndron për vizitë zyrtare në Kosovë

# Borissovi: Kosova do të përfaqësohet në Samitin e BE-së në Sofje

Kryeministri i Bullgarisë, Boyko Borissov, ka bërë me dije se Kosova do të përfaqësohet në Samitin e BE-së në Sofje, i cili do të mbahet më 16 dhe 17 maj. Teksa ka ftuar presidentin Hashim Thaçi të marrë pjesë në këtë samit, kryeministri bullgar ka thënë se Republika e Kosovës në këtë rast do të përfaqësohet ashtu siç e kanë njohur mbi 100 shtete

EPOKA  
ERE

Muhamet KOCI

**PRISHTINE, 16 PRILL** - Kryeministri i Bullgarisë, Boyko Borissov, i ka siguruar liderët institucionalë se Republika e Kosovës do të përfaqësohet më 16 dhe 17 maj në Samitin e Bashkimit Evropian në Sofje ashtu siç e kanë njohur mbi 100 shtete. Gjatë vizitës në Kosovë, ai e ka ftuar presidentin Kosovës Hashim Thaçi të jetë pjesë e samitit. "Kosova do të përfaqësohet ashtu siç e kanë njohur mbi 100 shtete. Siç e ka njohur edhe Bullgaria. Kurse për ato që nuk e kanë njohur do të gjejmë një zgjidhje", ka thënë Borissov në një konferencë të përbashkët për medie me presidentin Thaçi.

Ai ka thënë se ndërtimi i paqes dhe stabilitetit është në dobi të të gjitha palëve.

Borissov ka pohuar se tërë Evropa Juglindore e ka vendin në Bashkimin Evropian. "Bashkimi Evropian është i hapur për vendet e Evropës Juglindore. Sigurisht këto vende duhet t'i plotësojnë kushtet që ka vënë BE-ja për anëtarësim", është shprehur kryeministri bullgar.

Borissov ka vlerësuar se Bashkimi Evropian nuk importon kriza brenda BE-së prandaj, sipas tij, duhet të zgjidhen problemet para se të ketë aplikim për integrim në BE. "Ne nuk japim kështu, as nuk guxojmë të japim kështu, mirëpo në qoftë se nuk nënshkruhen marrëvesh-

je me Serbinë, as Kosova e as Beogradi nuk do të jenë pjesë e Bashkimit Evropian, sepse ky institucion nuk dëshiron vende anëtare me probleme mes vete. Prandaj, ne duam që ju t'i zgjidhni problemet mes vete. Parësore është që të mos shikojmë prapa, të shikojmë përpara dhe që në maj në Samitin e Sofjes t'u themi liderëve që, 'ja, popujt në Ballkan janë të vendosur'. Le të tregojmë urtësi", ka thënë Borissov.

Ai u ka bërë thirrje liderëve të Ballkanit Perëndimor t'i lënë mënjane egoizmat personale ngaqë, sipas tij, është fatale për të ardhmen e këtyre shteteve. "Dialogu është i paalternativë. Ju jeni të detyruar që bashkë me serbët të zgjidhni këtë mosmarrëveshje me njëra-tjetrën. Po ju drejtohem gjithë liderëve të Ballkanit, lëreni mënjane egoizmin sepse do të shkaktojë probleme në rajon", ka deklaruar kryeministri bullgar.

Kurse presidenti i Kosovës,

Hashim Thaçi, ka thënë se me kryeministrin bullgar janë pajtuar që e ardhmja e Kosovës është në NATO dhe në Bashkimin Evropian. Thaçi ka deklaruar se e ardhmja e kryeministrin Borissov në Kosovë është një nder i dyfishtë për vendin tonë sepse, përveç faktit se ai përfaqëson shtetin mik, Bullgarinë, njëherësh përfaqëson edhe presidencën bullgare të BE-së.

"Sivjet është publikuar Strategjia e Bashkimit Evropian dhe në këtë frymë ne jemi shumë falënderues për ndihmën e Bullgarisë. Si rezultat i kësaj kemi Samitin e Sofjes. Kosova kërkon jo vetëm ta vazhdojë dialogun me Serbinë, por të ketë një fqinjësi të mirë. Me kryeministrin diskutuam edhe për mundësinë e investimeve të Bashkimit Evropian në sektorin e infrastrukturës, duke përfshirë segmentet e Bullgarisë, Greqisë, Kosovës, Serbisë dhe tërë rajonit ku jetojmë ne, sepse vetëm duke investuar mund të kemi jetë më

të mirë", ka thënë Thaçi.

Ai ka bërë me dije se me kryeministrin bullgar ka diskutuar edhe për rrugën evropiane të Kosovës, të shteteve të Ballkanit Perëndimor, si dhe për marrëdhëniet bilaterale mes dy vendeve. "Bashkimi Evropian do të jetë i plotë vetëm atëherë kur Kosova dhe e tërë Evropa Juglindore të jenë pjesë e tij. Kjo nënkupton jo vetëm paqe e stabilitet, por edhe ngritje të mirëqenies së gjithëmbarshe", ka thënë Thaçi.

Kryeministrin e Bullgarisë, Boyko Borissov, e ka pritur në takim edhe kryeministri Ramush Haradinaj. Ky i fundit ka vlerësuar se Bullgaria ka një rol tejet të rëndësishëm në rajon. Haradinaj ka theksuar se Kosova është e përkushtuar për marrëdhënie të ngushta dhe bashkëpunim ekonomik dhe politik me këtë vend evropian. "Bullgaria e ka një aleatë, Kosovën. Jemi të nderuar me praninë tuaj në vend dhe vendet

tona nuk i ndanë asnjë temë", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se Kosova ka nevojë për miqtë e saj në procesin e liberalizimit dhe anëtarësimin në BE. "Bullgaria është një vend mik nga i cili presim mbështetjen në këtë proces. Kosova do të jetë gjithmonë e hapur për bashkëpunim ekonomik dhe politik me këtë vend. Ne edhe në të kaluarën kemi dëshmuar se mund të kemi partneritet të ngushtë", është shprehur Haradinaj.

Ndërsa kryeministri i Bullgarisë, Boyko Borissov, ka falënderuar Haradinajn për pritjen, duke shprehur përkushtimin e vendit të tij për forcimin e marrëdhënieve bilaterale mes dyja vendeve, partneritetit ekonomik dhe rrugën e përbashkët evropiane. "Midis shteteve tona nuk ka çështje të hapura. Synimet tona për investimet infrastrukturore dhe në fusha të tjera e kanë në fokus edhe Kosovën", ka thënë Borissovi.

## Kosova, pjesë e sesionit pranveror të Konferencës Globale Parlamentare



**WASHINGTON, 16 PRILL (ER)** - Me ftesë të Rrjetit Parlamentar të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, një delegacion i Kuvendit të Republikës së Kosovës po merr pjesë në Sesionin Pranveror të Konferencës Globale Parlamentare, në Bankën Botërore, në Uashington DC,

nga data 16 deri më 18 prill. Kuvendi përfaqësohet nga deputetët: Vjosa Osmani (LDK), Doruntinë Maloku (LDK), Safete Hadërgjonaj (PDK), Xhevahire Izmaku (PDK) dhe Fisnik Ismaili (GPD).

Temat kryesore për këtë sesion janë: Bashkëpunimi ndërkombëtar në çështjet e taksave,

problemet me rritjen e borxhit publik, politikat e fuqizimit të grave dhe punësimi i të rinjve, si dhe temat që kanë të bëjnë me ekonominë globale dhe qeverisjen e mirë. Në këtë takim global të parlamenteve deputetët do ta kenë mundësinë të takohen me përfaqësues të parlamenteve nga 65 vende të botës.

Flet për "Epokën e re", Mimoza Ahmetaj

# Kosova duhet ta avancojë procesin e in



## - Raporti i Progresit kërkon implementimin e agjendës evropiane

Ish-ministrja e Integritimit Evropian, Mimoza Ahmetaj, ka thënë se Raporti i Progresit do t'i evidentojë të arriturat dhe sfidat që e presin Kosovën. Ajo ka theksuar se në këtë raport do të kërkohet angazhim nga secili institucion për ta implementuar agjendën evropiane. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Ahmetaj ka pohuar se Kosova duhet ta vazhdojë luftimin e krimit dhe korrupsionit, reformat në drejtësi, si dhe reformat në administratën publike. Sipas saj, fokus kryesor i institucioneve duhet të jetë avancimi i procesit integruar. Ahmetaj ka vlerësuar se demarkacioni me Malin e Zi ka qenë mësim për të gjithë se sa i rëndësishëm është konsensusi politik në agjendën evropiane. Ajo ka shprehur optimizëm se gjatë këtij viti qytetarët e Kosovës do të lëvizin pa viza në vendet e BE-së

**EPOKA E RE**

Shqipe HETEMI

**PRISHTINE, 16 PRILL** - Ish-ministrja e Integritimit Evropian, Mimoza Ahmetaj, ka thënë të hënën se Raporti i Progresit i Komisionit Evropian do të kërkojë nga institucionet e Kosovës angazhim për ta implementuar agjendën evropiane. "Ne e kemi krijuar një përvojë me këto raporte, ku kërkohet angazhim nga të gjithë ne dhe secili institucion që ta implementojmë agjendën evropiane. Sigurisht se reformat nuk janë çdoherë shumë lehtë të pranueshme, por nuk duhet harruar se këto reforma na faturohen si suksese të vendit në këtë proces", është shprehur

Ahmetaj në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re". Ajo ka deklaruar se Kosova duhet ta vazhdojë luftimin e krimit dhe korrupsionit, reformat në drejtësi, si dhe reformat në administratën publike. Sipas Ahmetajt, vazhdimi i reformave mund ta shkurtojë rrugën e Kosovës drejt integritimit në Bashkimin Evropian. "Kosova është në proces të përmbushjes së obligimeve që dalin nga agenda evropiane. Në proces janë reformat në drejtësi, në administratën publike, në ekonomi, si dhe kemi shënuar progres në luftimin e krimit dhe korrupsionit. Nuk duhet harruar se Kosova ka filluar e fundit procesin integruar dhe fakti që ne kemi

pasur zgjedhje në vitin e kaluar, kjo e ka ngadalësuar procesin integruar. E rëndësishme për neve është që tani, pasi nuk parashihet të ketë zgjedhje të reja, fokusi ynë kryesor të jetë avancimi në këtë proces, duke përsheptuar hapat në reformat e filluara në mënyrë që ta shkurtojmë rrugën drejt integritimit. Për Kosovën po aq i rëndësishëm është edhe vazhdimi i dialogut me Serbinë dhe arritja e marrëveshjes për normalizim si dhe përmbyllja e procesit të liberalizimit të vizave", ka deklaruar ajo.

Ahmetaj ka vlerësuar se demarkacioni me Malin e Zi ka qenë mësim për të gjithë se sa është i rëndësishëm konsensusi

politik në agjendën evropiane. Ajo ka shprehur optimizëm se gjatë këtij viti qytetarët e Kosovës do të lëvizin pa viza në vendet e Bashkimit Evropian. "Kosova e ka përfunduar demarkacionin dhe ka shënuar progres në luftimin e korrupsionit dhe unë pres që tani institucionet e Bashkimit Evropian ta procedojnë më tutje çështjen e liberalizimit. Unë nuk shoh arsye që kjo të mos bëhet këtë vit dhe jam optimiste për këtë", ka theksuar Ahmetaj.

**"Epoka e re":** Znj. Ahmetaj, sot (e martë) do të publikohet Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën. Çfarë pritjesh keni nga ky raport dhe cilat mendoni se do të jenë të arriturat dhe ngeçjet e evidentuara?

**Ahmetaj:** Kosova tashmë e ka një përvojë me raportin e vendit, siç quhet, Raporti i Progresit. Nuk pres diçka më tepër nga ato që dihen se cilat janë obligimet tona dhe sa nga obligimet i kemi realizuar. Ne e kemi krijuar një përvojë me këto raporte, ku kërkohet angazhim nga të gjithë ne dhe secili institucion që ta implementojë agjendën evropiane. Sigurisht se reformat nuk janë çdoherë shumë lehtë të pranueshme, por nuk duhet harruar se këto reforma na faturohen si suksese

të vendit në këtë proces.

**"Epoka e re":** Si e vlerësoni punën e institucioneve sa i përket agjendës evropiane të Kosovës?

**Ahmetaj:** Strategjia afatmesme e Bashkimit Evropian për zgjerim 2015-2018 e ka përcaktuar se shtetet që synojnë anëtarësimin në BE duhet t'i përmbushin obligimet fundamentale siç janë reformat në rend dhe ligj, reformat në drejtësi, luftimi i krimit dhe korrupsionit, reformat në administratën publike dhe institucione demokratike si dhe reformat në ekonomi dhe konkurrueshmëri. Është shtytje shumë e madhe që si PDK-ja ashtu edhe institucionet tona e kanë prioritet agjendën evropiane dhe kjo është përparësi në raport me shtetet në rajon, që ka nga ato që janë më skeptike sa i përket integritimit në Bashkimin Evropian. Kosova është në proces të përmbushjes së obligimeve që dalin nga agenda evropiane. Në proces janë reformat në drejtësi, në administratën publike, në ekonomi, si dhe kemi shënuar progres në luftimin e krimit dhe korrupsionit. Nuk duhet harruar se Kosova ka filluar e fundit procesin integruar dhe fakti që ne kemi pasur zgjedhje në vitin e kaluar, kjo e ka ngadalësuar procesin

## tegrimit

# Luan Shkëlzen Haradinaj: Dëshmorët e deshën dhe ëndërruan një shtet të fortë

Në Pejë është mbajtur academia përkujtimore me rastin e 19-vjetorit të rënies së dëshmorëve Shkëlzen Haradinaj, Fatmir Nimanaj, Hasim Halilaj dhe Luan Nimanaj. Në emër të familjeve të dëshmorëve ka folur djali i heroit Shkëlzen Haradinaj, Luani, i cili ka thënë se dëshmorët e deshën dhe ëndërruan një shtet të fortë

**PEJË, 16 PRILL (ER)** - Presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë marrë pjesë të hënën në akademinë përkujtimore për heroinë e kombit, gjeneral Shkëlzen Haradinaj, dëshmorët Fatmir Nimanaj, Hasim Halilaj dhe Luan Nimanaj, organizuar nga Shoqata e Veteranëve të UÇK-së e rajonit të Dukagjinit. Në këtë akademi është përkujtuar edhe Enver Haradinaj.

Fillimisht kryeministri Haradinaj, i shoqëruar edhe nga familjarët e tij, bëri homazhe dhe vuri buqeta me lule pranë bustit të heroit Shkëlzen Haradinaj dhe te pllaka e dëshmorëve dhe heronjve të Pejës. Në këtë akademi nga një fjalë rasti mbajtën presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, Gafurr Elshani në emër të Zonës Operative të Zonës së Dukagjinit, Brahim Selmanaj në emër të bashkëluftëtarëve dhe në emër të familjeve të dëshmorëve që u përkujtuan, foli djali i heroit Shkëlzen Haradinaj, Luan Shkëlzen Haradinaj. Duke i falënderuar të pranishmit, Luan Shkëlzen Haradinaj tha: "Shembulli i dëshmorëve të kombit do të jetë gjithmonë udhërrëfyes për ne, në rrugën e ndërtimit të një shteti të fortë, ashtu siç e deshën dhe e ëndërruan ata", ka thënë Luan Shkëlzen Haradinaj. Ndërkaq presidenti Hashim Thaçi ka thënë se me nderimet më të larta institucionale po përkujtohen këta katër dëshmorët të rënë heroikisht më 16 prill 1999. "Liria ka qenë dhe mbetet vlera më e çmuar e njerëzimit", ka thënë ai, duke shtuar se "rënia për liri është sakrificë më supreme", ka thënë Thaçi.



Kreu i shtetit ka thënë se për dalim nga të gjitha periudhat historike, në vitet 1998-1999 përpjekjet për çlirim të Kosovës ishin një realitet më i dukshëm se kurrë më parë. Ai ka thënë se jo vetëm komandantët e shquar ishin sprovuar për dy vjet në betejë e fronte lufte, por edhe të rinjtë 20-vjeçar si Luan Nimanaj ishin të gatshëm për të luftuar deri në pikën e fundit të gjakut. "Ushtria Çlirimtare e Kosovës, si organizatë ushtarake dhe politike, kishte bashkuar djemtë dhe vajzat, burrat dhe gratë më të vendosur që ta bëjnë realitet ëndrën e shumë brezave, çlirim të Kosovës", u shpreh presidenti Thaçi.

Ai ka thënë se Shkëlzen Haradinaj ishte një ndër pjesëtarët e hershëm të UÇK-së, i cili me energji të pashtershme ndihmonte lëvizjen e pjesëtarëve të UÇK-së që furnizoheshin me armatim, duke shtuar tutje se "Luan Haradinaj kishte rënë dëshmor në luftën pranë kufirit, në përpjekje për të hyrë sa më parë në Kosovë, që në maj 1997", është shprehur Thaçi. I pari i vendit ka thënë se Shkëlzeni, Fatmiri, Hasimi dhe Luani kontributin e tyre e dëshmuar sidomos në periudhën e luftës së hapur të UÇK-së. "Këta ushtarë, komandantë dhe drejtues të luftës çlirimtare në Zonën Operative të Dukagjinit,

që nga beteja e 24 marsit 1998 në Gillogjan e deri tek rezistenca e 16 prillit 1999, e bartën me nder uniformën e UÇK-së", u shpreh presidenti Thaçi.

Një nga vlerat e shumta të UÇK-së, presidenti Thaçi ka thënë se ka qenë mbrojtja e popullatës civile, kujdesi ndaj të plagosurve dhe gatishmëria e ushtarëve dhe eprorëve për t'u sakrifikuar për popullatën e paarmatosur. "Shembulli më tipik është 16 prill 1999, dita kur ranë dëshmorët Shkëlzen Haradinaj, Fatmir Nimanaj, Hasim Halilaj dhe Luan Nimanaj", ka theksuar ai.

Presidenti Thaçi ka shtuar se sot jemi krenarë që i përkasim atij brezi që kurorëzoi përpjekjet shekullore për liri dhe pavarësi. "Sot Kosova është shtet i lirë dhe sovran. Kjo Kosovë ka qenë ëndërr e shumë brezave që nga kryengritjet e Haxhi Zekës deri tek aktiviteti patriotik dhe intelektual i Jusuf Gërvallës, emrin e të cilit e mbajti me nder Brigada 131 e Zonës Operative të Dukagjinit", ka pohuar presidenti Thaçi.

Kreu i shtetit ka theksuar se, pavarësisht prej sfidave, Kosova brenda një periudhe 19-vjeçare ka dëshmuar të arritura të mëdha dhe çdo ditë e më shumë po e forcon identitetin shtetëror si në planin e brendshëm, po ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Ai ka thënë se Kosova, për të cilën u sakrifikuan Shkëlzeni, Fatmiri, Hasimi, Luani dhe shumë dëshmorë të tjerë, është rëfim i suksesshëm i krijimit të shtetit dhe i ndërtimit të paqes.



integruar. E rëndësishme për neve është që tani, pasi nuk parashihet të ketë zgjedhje të reja, fokusi ynë kryesor të jetë avancimi në këtë proces, duke përsheptuar hapat në reformat e filluara në mënyrë që ta shkurtrojmë rrugën drejt integritetit. Për Kosovën po aq i rëndësishëm është edhe vazhdimi i dialogut me Serbinë dhe arritja e marrëveshjes për normalizim si dhe përmbyllja e procesit të liberalizimit të vizave.

**"Epoka e re":** Nga këndvështrimi juaj, si e shihni procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën?

**Ahmetaj:** Çështja e demarkacionit me Malin e Zi ka qenë mësim për të gjithë ne se sa është i rëndësishëm konsensusi politik në agjendën evropiane. Kosova e ka përfunduar demarkacionin dhe ka shënuar progres në luftimin e korrupsionit. Unë pres që tani institucionet e Bashkimit Evropian ta procedojnë më tutje çështjen e liberalizimit.

**"Epoka ere":** Kur janë gjasat reale që qytetarët e Kosovës të lëvizin pa viza në vendet e Bashkimit Evropian?


**Ahmetaj:** Unë nuk shoh arsye që kjo të mos bëhet këtë vit dhe jam optimiste për këtë.

# 14 vjet burgim për vrasësit e Aulon Zekës

Prishtinë, 16 prill - Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur fajtorë tre të miturit për vrasjen e të riut, Aulon Zeka. I mituri i parë është dënuar me 9 vjet e 6 muaj burgim, e mitura e dytë me 3 vjet burgim, ndërsa ndaj të tretit është shqiptuar masa e mbikëqyrjes nga organet e kujdestarisë për një

vjet e gjashtë muaj. I mituri i parë është dënuar për kryerjen e veprës penale të vrasjes, e mitura e dytë është dënuar për ndihmë në fshehjen e veprës penale dhe i mituri i tretë për moslajmërim të veprës penale. Për vrasjen e Aulon Zekës akuzoheshin dy të mitur, ndërsa një tjetër po ngarkohet

për moslajmërim të kësaj vepre penale. Aulon Zeka u vra më 16 shtator në vitin 2017 në Prishtinë. Seancat e këtij gjykimi kanë qenë të mbyllura, ndërsa gati sa herë ato janë zhvilluar te Pallati i Drejtësisë, ka pasur protesta për ndriçimin e vrasjes së Aulon Zekës.



## Kurti i thotë ambasadorit italian se vendi duhet të shkojë në zgjedhje të reja

**EPOKA E RE** Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 16 PRILL - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e Italisë në Kosovë, Piero Cristoforo Sardim, me të cilin ka biseduar për zhvillimet e fundit në vend. Sipas një njoftimi të LV-së, temë e diskutimit ishte qeveria e pakicës parlamentare që është ende në pushtet në Kosovë si dhe për punën dhe kërkesat e forcave opozitare në vend në lidhje me situatën e krijuar. Kurti ka shpjeguar se si Lëvizja Vetëvendosje i sheh zgjedhjet e parakohshme në vend si zgjedhje drejt një qeverie legjitime të shumicës për tema të rëndësishme ekonomike dhe sociale

për vendin, pa mbetur peng, siç ka mbetur kjo qeveri, e temave të imponuara. Në këtë njoftim bëhet me dije se u diskutua edhe për procesin e integritetit në BE në pritje të raportit të progresit për Kosovën që publikohet këtë javë. Gjithashtu, në këtë takim u trajtua edhe dialogu me Serbinë dhe tentativa për riaktualizimin e "Zajednicës". Në këtë pikë Kurti ka theksuar edhe një herë nevojën për të nisur një dialog nga poshtë e për zhvillim me serbët që janë qytetarë të Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh edhe faktin se vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës e ka shpallur marrëveshjen për "Zajednicën" në s'përputhje me plot 23 nene të Kushtetutës.



## Hapet konkursi për policë të rinj



Sipas njoftimit të PK-së, formularët për aplikim mund të merren në zyrat e personelit të drejtorive rajonale, në stacionet policore, ose të tërhiqen nga uebfaqja e policisë

PRISHTINË, 16 PRILL - Policia e Kosovës (PK) ka hapur të hënën konkurs për pranimin e pjesëtarëve të rinj. Kushtet për pranim për pjesëtar të Policisë së Kosovës janë: të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, të jetë i moshës 18-30-vjeçar, të ketë të përfunduar shkollimin e mesëm, të jetë në gjendje të mirë fizike, mentale dhe emocionale, të mos jetë i dënuar për ndonjë vepër penale, të mos ketë në vend të dukshëm tatuazh (fytyrë, qafë, duar), të ketë integritet personal dhe vlera të larta etike. Sipas njoftimit të policisë, kandidatët në këtë

konkurs do t'i nënshtrohen testit me shkrim, testit të aftësive fizike, intervistës, testit psikologjik, kontrollimit mjekësor, verifikimit të së kaluarës. Dokumentet e nevojshme për këtë konkurs janë kopja e diplomës për arsimin e mesëm të lartë ose certifikata, ndërsa kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit kopja e diplomës ose e certifikatës e notrifikuar, dëshmi për kualifikime të tjera, certifikata e lindjes, ose ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile (të nxirret pas datës së shpalljes së konkursit),

vërtetimi nga gjykata që nuk është i dënuar dhe që nuk është nën hetime (të nxirret pas datës së shpalljes së konkursit), kopje të letërnjoftimit ose pasaportës së vlefshme, një fotografi të formatit (5 x 5). Sipas njoftimit të PK-së, formularët për aplikim mund të merren në zyrat e personelit të drejtorive rajonale, në stacionet policore, ose të tërhiqen nga uebfaqja e policisë. Aplikacionet dorëzohen personalisht në zyrën e personelit pranë drejtorive rajonale në Prishtinë, Mitrovicë e jugut, Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë e veriut dhe Gjakovë, çdo ditë pune prej orës 09:00-15:00. Konkursi do të jetë i hapur nga dita e hënës e deri më datën 10/05/2018.

## Së shpejti pritet të hapet parkingu nëntokësor në kryeqytet

PRISHTINË, 16 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije të hënën se në Komitetin Ndërmënyësor për Partneritet Publiko-Privat ka kaluar projekti i parkingut të madh nëntokësor te Fakulteti

i Filologjisë, me minimum 500 vendparkime. Ai ka falënderuar Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe drejtorin Genc Bashota si edhe "Deloitte" që kanë ndihmuar për fizibilitetin e këtij projekti

madhor. "Në dy javët në vijim do të organizohet një takim informues me investitorët potencialë dhe shumë shpejt projekti del në tenderim", ka thënë Ahmeti, duke shtuar se ky është super projekt për kryeqytetin.



# Kuvendi nuk e themelon komisionin për të dëbuarit turq

Në seancën e Kuvendit të Kosovës të hënën u propozua që në rend dite të hyjë themelimi i Komisionit Hetimor Parlamentar për deportimin e gjashtë shtetasve turq, por një gjë e tillë nuk u bë pasi deputetët refuzuan të marrin pjesë në votim. Në momentin e votimit në sallë ishin 67 deputetë, nga ta 59 morën pjesë në votim, e prej këtyre 58 ishin për dhe një ka abstenuar

**PRISHTINË, 16 PRILL (ER)** - Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur të votojë të hënën për futjen në rend të ditës të propozimit të Grupit Parlamentar të LDK-së për formimin e një komisionit hetimor lidhur me dëbimin e gjashtë shtetasve turq nga Kosova. Për këtë propozim nuk pati kuorum dhe në votim morën pjesë vetëm 59 deputetë. "E përsërisim votimin për të tretën herë. Vetëm 59 deputetë kanë votuar", ka thënë kryesuesi i seancës, Xhavit Haliti. Në momentin e votimit në sallë ishin 67 deputetë, nga ta 59 morën pjesë në votim, e prej

tyre 58 ishin për dhe një ka abstenuar. "Nuk ka vendim", ka thënë Haliti. Deputetët kanë debatuar për këtë çështje para se të votonin, mirëpo nuk janë pajtuar lidhur me atë se kush duhet ta udhëheqë komisionin në fjalë. Në mungesë të kuorumit, deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk ratifikuan anëtarët e Këshillit Shtetëror të Cilësisë së Agjencisë së Kosovës për Akreditim. Ky institucion që shtatë muaj është jashtë funksionit pasi me vendim të kryeministrit Ramush Haradinaj, ministri i Arsimit,



Shyqiri Bytyqi, kishte shkarkuar bordin që kryesohej nga Blerim Rexha.

Në Kuvend ishin 48 deputetë, ku prej tyre 45 votuan për rati-

fikimin, ndërsa tre të tjerë abstenuan, ndërsa nuk pati asnjë kundër. "Janë 48 deputetë, 45 votuan për, ndërsa tre abstenuan. Nuk ka kuorum

për votim andaj vazhdojmë me pikën e rendit tjetër të ditës", ka thënë nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti, i cili po udhëhiqte seancën plenare.

# Behgjet Pacolli nderohet me titullin 'Qytetar Nderi i Kukësit'

Me rastin e shënimit të 19-vjetorit të eksodit kosovar në Kukës, zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, është nderuar me titujt "Qytetar Nderi i Kukësit" dhe "Nderi i Qarkut Kukës" për kontributin e tij dhënë në mbështetje të luftës çlirimtare dhe të kampeve të bashkëkombësve të larguar nga lufta

**EPOKA  
ERE** **Faton DERMAKU**

**PRISHTINË, 16 PRILL** - Bashkia e Kukësit të hënën ka nderuar me titujt "Qytetar Nderi i Kukësit" dhe "Nderi i Qarkut Kukës" zëvendëskryeministrin e parë dhe ministrin e Punëve të Jashtme, Behgjet Pacollin. Ministrin Pacollit i janë ndarë këta dy tituj për kontributin e tij dhënë në mbështetje të luftës çlirimtare, të kampeve të bashkëkombësve të larguar nga lufta, si dhe për vizionin e tij për krijimin e hapësirës së përbashkët ekonomike kombëtare. Me këtë rast, kryetari i Bashkisë së Kukësit, Bashkim Shehu, ka thënë se kompania e Pacollit ka bërë shumë për Kukësin. Sipas tij, platforma e Pacollit për një zonë të lirë ekonomike ndërkuftare është shpëtimtare për njërin nga zonat më të bukura dhe me potencial zhvillimor. "Kompania juaj e ka ndihmuar

luftën e shenjtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me shumica të mëdha financiare. Ju keni ndihmuar Kukësin edhe në kohë paqeje. Të afërmit tuaj kanë sjellë ndihma për fshatra të thellë të qarkut tonë. Ju po na ndihmoni me vizionin tuaj për rrëzimin e atyre kufijve që kanë mbetur ende mes nesh. Do të na ndihmoni edhe më shumë kur ky vizion të bëhet realitet. Platforma juaj për një zonë të lirë ekonomike ndërkuftare që bashkon Gjakovën dhe Prizrenin me qarkun tonë është shpëtimtare për njërin nga zonat më të bukura të Ballkanit dhe me plot potencial zhvillimor. Koncepti juaj për zhvillimin e Aeroportit të Kukësit, për kompani ajrore të përbashkët; koncepti juaj për një qendër spitalore elitare dhe një shkollë të lartë shërbimesh mjekësore në Kukës, janë shpëtimtare për këtë zonë të varfër, por dinjitoze", ka thënë



Shehu. Ndërsa zëvendëskryeministri

Behgjet Pacolli ka thënë se mikpritja e Kukësit ka shpëtu-

ar popullin e Kosovës gjatë luftës. Ai ka treguar se është duke u angazhuar që Lugina e Drinit të shndërrohet në një vektor komunikacioni nga më të rëndësishmit në Evropë. "Kukësi është kryeqyteti i mikpritjes botërore. Kukësi është nobeli i humanizmit global. Kukësi e shpëtoi Kosovën në vitin 1999. Ndaj për mua është krenari që prej sot jam një kuksian, që prej sot jam njeri si ju. Ju falënderoj, kryetar i Kukësit, Bashkim Shehu, që më propozuat të jem njëri nga ju. Ju falënderoj juve zotërinj të Këshillit Bashkiak dhe të Këshillit të Qarkut, që unanimisht keni votuar për mua", ka thënë Pacolli.



## 50 familje nga kategoritë e luftës përfitojnë banesa nga Komuna e Prishtinës

**PRISHTINË, 16 PRILL** - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije të hënën se ka nënshkruar kontratat për 50 banesa për kategoritë e dala nga lufta. "Pas një procesi disamujorë familjet më meritore do të përfitojnë nga ky program i Komunës së Prishtinës", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".

# Ministri Hasani merr masa mbrojtëse për qumështin



Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, ka marrë masa për mbrojtjen e prodhuesve vendorë të qumështit. Vendimi ka ardhur pas një hetimi që është konstatuar se importi nga Bosnja dhe Hercegovina është rritur mbi masën 20 për qind dhe ka ndikuar në dëmtimin e produkteve vendore

**EPOKA  
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 16 PRILL - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, me qëllim të vazhdimin të mbrojtjes së prodhimit vendor, që është prioriteti i saj, pas një hetimi të departamentit përkatës, ministri Bajram Hasani ka marrë masa mbrojtëse për qumështin, duke u bazuar në kompetencat ligjore në pajtim me nenin 1 dhe paragrafin 1, të nenit 2 të Ligjit nr. 041/L-047, si dhe dispozitat përkatëse të Marrëveshjes së CEFTA-s.

MTI-ja ka njoftuar se ky vendim ka ardhur pas një hetimi që është konstatuar se importi nga Bosnja dhe Hercegovina është rritur mbi masën 20 për qind dhe ka ndikuar në dëmtimin e produkteve vendore për faktin se importi i produkteve të qumështit nga Bosnja dhe Hercegovina është me çmim të ulët, i cili është nën

koston e prodhimeve vendore të qumështit. "Siç parashihet në nenin 8 të Ligjit për Masat Mbrojtëse në Importe, se ka bazë të mjaftueshme për të përcaktuar se rritja e importit, si dhe kushtet në të cilat kryhet ky import, do t'u shkaktojë dëme serioze prodhuesve vendorë të produkteve të ngjashme, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është e autorizuar, në bazë të dëshmimeve të mjaftueshme, ta zbatojë ligjin për t'i mbrojtur prodhuesit e produkteve të qumështit kur kërcënohen të përbëjnë dëme serioze nga importi i qumështit me origjinë nga Bosnja dhe Hercegovina", është bërë me dije në njoftimin e MTI-së.

MTI-ja ka theksuar se këto masa mbrojtëse prekin mijëra prodhues dhe përpunues të qumështit që operojnë në tregun e Kosovës. "Ministria e Tregtisë dhe Industrisë do t'i vazhdojë

masat mbrojtëse për prodhuesit vendorë, në momentin që vërtetohet se ka bazë ligjore. Kjo masë mbrojtëse afekton rreth 3 000 bujq fermerë që kanë ferma me nga 5 deri në 250 lopë, me mbi 30 përpunues të qumështit", është thënë në njoftimin e MTI-së.

Klubi i Prodhuesve të Kosovës (KPK) ka përkrahur vendimin e MTI-së për masat mbrojtëse për prodhimet e qumështit. "Klubi i Prodhuesve të Kosovës e përkrah vendimin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vendosjen e masave mbrojtëse për importin e qumështit me origjinë nga Bosnja dhe Hercegovina. Ky vendim ka qenë i nevojshëm kur kemi parasysh faktin se importi i qumështit nga Bosnja dhe Hercegovina ka ardhur me çmim më të ulët se kostoja e prodhimeve vendore të qumështit, po ashtu duke marrë parasysh edhe rritjen e këtij importi në tregun vendor ku, si pasojë, ka dëmtuar thellësisht pozitën e prodhimeve vendore të qumështit", është thënë në komunikatën e KPK-së. Klubi i Prodhuesve të Kosovës ka theksuar se sektori i qumështit në Kosovë vlerësohet si një ndër sektorët me më së shumti të punësuar dhe si një ndër sektorët më me perspektivë në zhvillimin ekonomik të vendit.

"Klubi i Prodhuesve të Kosovës mbështet çdo vendim ku mbrohen drejtpërdrejt interesat e prodhuesve vendorë. Duhet të kihet parasysh se ky vendim për masat mbrojtëse ndaj importit ndikon tek prodhimi i bujqve, fermerëve dhe te përpunuesit e qumështit. Masa të këtilla mbrojtëse mirëprehen nga Klubi i Prodhuesve të Kosovës sepse

përbëjnë një lehtësim të madh për prodhuesit vendorë, po ashtu Klubi edhe në të ardhmen do të vazhdojë të përkrahë MTI-në për çdo vendim që mbështet prodhuesit vendorë dhe në të njëjtën kohë e inkurajon atë t'i vazhdojë politikat të cilat e fuqizojnë prodhimin e vendit", është thënë në komunikatën e Klubit të Prodhuesve të Kosovës.

## Fermerët dhe qumështarët mirëpresin vendimin e MTI-së

Shoqata e Fermerëve dhe Qumështarëve ka vlerësuar se lajmi që Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka vendosur masë të përkohshme mbrojtëse për importin e qumështit nga Bosnja dhe Hercegovina është një ndër lajmet më të mira që kanë ndodhur në sektorin e tyre në vitet e fundit. "Ne kemi ngritur disa herë zërin ndaj pabarazisë së tregtisë në mes të Bosnjës dhe Kosovës dhe jemi të gëzuar që zëri ynë më në

fund është dëgjuar. Falënderojmë këtë ministri për angazhimin që ka treguar kohën e fundit në këtë drejtim dhe presim edhe vendime të tjera me qëllim të mbrojtjes së produkteve vendore të qumështit. Me këtë rast u bëjmë thirrje edhe institucioneve të tjera përgjegjëse për rregullimin dhe kontrollin e tregut që ta kryejnë obligimin e vet ligjor dhe të na krijojnë hapësirë për punë", është thënë në njoftimin e tyre.



# Edhe 12 objekte publike bëhen me masa të efijencës së energjisë

"Projekti për 12 objektet e para parasheh një investim rreth 2.3 milionë euro. Po ashtu, presim edhe 20 objekte të tjera që të përrurohen deri në shtator të këtij viti, kurse janë në fazën finale të tenderimit edhe 23 objekte shtesë, të cilat shpresojmë se, me një intensitet të punës, do të përfundohen deri në fund të këtij viti", ka thënë ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka

**EPOKA ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 16 PRILL** - Nga dita e hënë edhe 12 objekte publike janë bërë me masa të efijencës së energjisë falë investimit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, përmes kredisë së Bankës Botërore për Projektin e Kosovës për Efijencë të Energjisë dhe Energji të Ripërtërishme, ndërsa vlera e përgjithshme e kësaj faze arrin në 2.3 milionë euro. Në inaugurimin e kësaj faze të projektit ishin ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, drejtori i Bankës Botërore për Kosovë, Marco Mantovanelli, ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, drejtori i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, Basri Sejdiu dhe përfaqësues të tjerë të institucioneve dhe të QKUK-së.

Pas prerjes së shiritit inaugurohet para objektit të Klinikës së Stomatologjisë të QKUK-së, i cili është një nga objektet ku janë zbatuar këto masa, ministri Valdrin Lluka ka theksuar se me zbatimin e këtij projekti jo vetëm se do të ketë kushte

më të mira për pacientët dhe stafin, por do të ketë edhe kurse më të energjisë elektrike në fatura diku rreth gjysmë milion euro, gjë që do të ndikojë edhe në kursimin e buxhetit të Republikës së Kosovës. "Projekti për 12 objektet e para parasheh një investim rreth 2.3 milionë euro. Po ashtu, presim edhe 20 objekte të tjera që të përrurohen deri në shtator të këtij viti, kurse janë në fazën finale të tenderimit edhe 23 objekte shtesë, të cilat shpresojmë se, me një intensitet të punës, do të përfundohen deri në fund të këtij viti", ka thënë ministri Lluka.

Kreu i MZHE-së ka theksuar se këto 50 objekte që mund të përfundojnë deri në fund të këtij viti do të ndihmojnë dukshëm në konsumin më të ulët të energjisë elektrike të vendit. Ai ka thënë se projekti me Bankën Botërore është shumë i madh dhe parasheh renovimin e rreth 140 objekteve që të bëhen efijente. Në këtë drejtim ai ka shprehur falënderimin e tij për kontributin që ky institucion po jep në fushën e EE-së.



Ndërsa drejtori i Bankës Botërore për Kosovë, Marco Mantovanelli, ka thënë se ky institucion po mbështet Qeverinë e Kosovës për të krijuar objekte me energji efijente dhe energji të ripërtërishme me një hua prej 31 milionë dollarësh. Ai ka pohuar se objektivat e këtij projekti janë që të ketë më shumë efikasitet për shpenzimin e parasë publike. "Ne presim që pas përfundimit të këtij projekti me këto kurseme fondet publike të kursehen në

shumën rreth 18 milionë euro në vit, ndërsa objektivi i dytë është të zvogëlohet kërkesa për energji, objektivi i tretë është ambienti më i pastër dhe objektivi i katërt është që përmes këtij projekti të krijohen vende pune", ka thënë Mantovanelli.

Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë se renovimi i këtyre objekteve spitalore është model i mirë që të bëhet edhe tek objektet e tjera spitalore. "Nuk do të ndalemi, por do të vazhdojmë edhe në të ardhmen

me reforma të tilla të cilat kontribuojnë në përmirësimin e shëndetit të pacientëve dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës", ka thënë ministri Ismaili.

Kurse drejtori i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, Basri Sejdiu, ka vlerësuar se ky projekt është një ndihmesë e madhe duke llogaritur se me të krijohen mundësitë që mjetet e kursyera të shfrytëzohen për barna ose për projekte që janë jetike për pacientët.

## Panairi 'Prishtina 2018', qendër e promovimit të vlerave ekonomike në Ballkan

**PRISHTINË, 16 PRILL (ER)** - Përfaqësuesit e Odës Ekonomike të Kosovës (OEK) kanë mbajtur të hënë konferencë për media lidhur me panairin e përgjithshëm ndërkombëtar "Prishtina 2018", i cili do të mbahet prej datës 18 deri më 21 prill. Në këtë konferencë u tha se ky panair i cili organizohet për të nëntëmbëdhjetën herë ka rëndësi jo vetëm për vendin, por edhe për rajonin e më gjerë.

Kryetari i OEK-ut, Safet Gërxhaliu, ka thënë se pjesëmarrja e 174 kompanive nga vende të ndryshme dëshmon fuqinë integruese të këtij panairi. Ai ka thënë se ky panair do ta shndërron Prishtinën në një kryeqytet të rajonit për faktin se është panairi më i madh në Ballkan.

"Prej datës 18 deri më 21 prill Prishtinën do ta shndërrojmë në qendër të promovimit të vlerave ekonomike në Ballkan dhe më gjerë", është shprehur ai. Gërxhaliu ka kërkuar nga Komuna e Prishtinës ta pastrojë rrugën që dërgon në panair për shkak se aty ka shumë mbeturina.

Kryetari i OEK-ut e ka komentuar edhe pjesëmarrjen e Shqipërisë me vetëm një kompani. "Duhet të mendojmë çka po ndodh me bashkëpunimin ekonomik në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. Ata duket se janë të gatshëm të bashkëpunojnë me të tjerët, por jo edhe me Kosovën. Gara më e madhe po bëhet për të shtuar barrierat e jo për t'i eliminuar ato", ka thënë Gërxhaliu.



# Politika dhe morali

## Rreziku nga shprishja e politikës dhe nevoja për rikthim drejt moralit



**Dr. Sabri KİÇMARI**

Politika dhe morali janë dy nocione, raportet e të cilave mes vete janë mjaft interesante, sidomos nga këndvështrimi i politikës si praktikë. Shpeshherë qytetarët, zgjedhësit, votuesit i ngatërrojnë pa qëllim këto dy nocione. Por, jo rrallë pushtetarët dhe synuesit e pushtetit i ngatërrojnë me qëllim ato. Zbulimi i raporteve të drejta në mes të moralit dhe politikës dhe zhveshja e tendencave të pushtetarëve dhe synuesve të pushtetit për të manipuluar me këto raporte është një detyrë që në vendet e zhvilluara industriale me sistem shumëpartiak i obligojnë këto segmente të rëndësishme të shoqërisë: shkencëtarët politikë, sociologët, filozofët dhe përfaqësuesit e medieve.

Në rastin e Kosovës kryerja e një detyrë të tillë has në vështirësi të theksuara. Së pari, literatura filozofike, sociologjike dhe shkencore politike në Kosovë ka filluar të depërtojë, e përkthyer, në të shumtën e rasteve, shkel e shko. Përkthimi i vetëm një numri fare të vogël, të librave të klasikëve të filozofisë si Platoni, Aristoteli, Thomas von Aquin, Hobsi, John Locku, Kanti, Hegeli, Kirkegaardi dhe përfaqësuesve të filozofisë bashkëkohore si Edmund Husserl, Bertrand Russell, Karl Jaspersi, Martin Heidegeri, Max Horkheimer, Theodor Adorno, Jean - Paul Sartre, John Raëls, Amitai Etzioni, Jürgen Habermas etj. sigurisht lë pasojë për subvencionimin e të menduarit dhe të vepruarit politik. Së dyti, nga mbizotërimi i skenës mediale për decenie të një botëkuptimi jokritik në raport me politikën, digjitalizimi i mediave informative ka sjellë me vete një mësim të jashtëzakonshme për të kritikuar apriori, me vend e pa vend, me dhe pa argumente, për të fituar pëlqime në rrjete sociale, lexime sipërfaqësore dhe jopërmbytësore. Sigurisht ka edhe shembuj pozitiv të matjes së fjalës së shkruar publike, por trendi, për fat të keq është mjaft negativ.

### Definimi i moralit dhe etikës politike

Për të krijuar një pikëpamje për politikën si shkencë është njohja e historisë së ideve dhe koncepteve teorike të filozofisë politike domosdoshmëri. Për të krijuar një vetëdije për politikën si veprimtari praktike duhet njohur rregullat e sjelljes si politikan në situatat e krijuara politike. Në të dy rastet e dhëna parakusht është dallimi i qartë i raportit në mes të politikës dhe moralit. Morali paraqet tërësinë e parimeve, normave dhe rregullave që përcaktojnë sjelljen e njerëzve në shoqëri. Etika definohet si disiplinë e filozofisë, e cila në mënyrë metodike dhe sistematike studion veprimin moral. Bazë e studimit të etikës është studimi i mundësisë të një morali të tillë, sipas të cilit në mund të jetojmë mirë, të veprojme drejtë dhe të gëzojmë arsyes.

Politika si shkencë ka lidhje të rëndësishme me etikën. Ajo përmban gjithnjë edhe anën e saj morale. Etika politike studion mundësitë e argumentimit të principeve etike (parimeve, aksiomave), normave (ligjeve dhe rregullave) dhe virtyteve (pikëpamjeve, ideve). Në veprimtarinë shoqërore-shpirtërore janë të njohura të dy dimensionet: si dështimi moral i politikës (i aktorëve politikë), ashtu edhe dështimi i tendencave moralizuese të politikës. Dështim moral i politikës mund të konsiderohet rasti kur ai, në luftë për pushtet, vë në zbatim mjete të palejueshme morale (fyerja, përcmimi, ndjekja dhe vrasja e kundërshtarit politik). Por, pika kulmore e dështimit të një politikani dhe politikës së tij në tërësi mund të arrihet, në rast se politikani, për të mbrojtur fatin e tij individual, firmos vendime që kanë të bëjnë me fatin e një kombi (ose shtetit), në kundërshtim me interesat dhe vullnetin e këtij kombi (ose shtetit).

Edhe tendenca e moralizimit të politikës është e gabuar. Moralizimi i politikës mund të sjellë për pasojë heqjen dorë nga pragmatizmi në veprimin praktik politik dhe kufizimi i veprimit brenda një kornize të ngushtë moralizuese, shpesh religjioze ose ideologjike. Po të zbatohet në praktikë një metodë e tillë, atëherë shumë nga Konferencat Paqësore, Marrëveshjet Diplomatike dhe veprime të

tjera praktike nuk do të mund të gjejnë zbatim. Kërkesa për zbatimin me çdo kusht (edhe me dhunë) të rregullave moralizuese në politikë shpesh është sqaruar me idenë e krijimit të "njeriut të ri". Mjetet që janë përdorur për imponimin e moralit të tillë janë të palejueshme. Këtë synim kryesisht mundoheshin të realizonin në praktikë ideologjitë e shekullit të kaluar. Një sistem i tillë u bë për qytetarët i padurueshëm. Për këtë dëshmon dështimi i këtyre shteteve edhe në rrafshin politik, edhe në atë moral, ekonomik, kulturor dhe shpirtëror.

Zgjidhja e drejtë e raportit në mes të moralit dhe politikës është një drejtpeshim i qëndrueshëm mes tyre: as zbatim ekskluziv i moralit dhe nënçmim i politikës, por as zbatim ekscesiv i politikës dhe lënia anash e së moralshmes. Sidomos një gjë e tillë duhet të kihet parasysh në situata zgjedhore, kur partitë dhe kandidatët synojnë të arrijnë suksese më të mëdha elektorale.

### Tipat e etikës politike

Megjithëse paraqitja e të gjitha varianteve të të konceptuarit të etikës politike nga përfaqësuesit e teorisë politike do të kërkonte hapësirë më të madhe shpjegimi të veçorive, metodave dhe përfundimeve të tyre teorike, në këtë rast do të koncentrohemi vetëm në tiparet themelore të pesë klasikëve të mendimit politik: Aristotelit, Makiavelit, Kantit, Hegelit dhe Marksit.

### Etika e qytetarit

Aristoteli përfaqëson konceptin antropologjik të teorisë politike. Ai e ndërton teorinë e tij për polis (shtetin) dhe kushtetutën e tij mbi bazën e bashkësisë së qytetarëve. Qytetarët janë për të qenie të arsyeshme dhe të afta për të përdorur gjuhën si mjet të bashkëveprimit politik - të krijimit të bashkësisë: pra ai e definon njeriun si zoon politikon (qenie politike). Përmes polisit qytetarët synojnë të rrisin kënaqësinë e tyre dhe përsosmërinë. Konceptimi aristotelian (antropologjik) i politikës i parapriu idesë së të drejtave të individit në shoqëri, të përfaqësuar nga Iluministët dhe ka një lidhshmëri organike me idenë e shtetit të lirë kushtetues. Koncepti bazë i etikës politike të Aristotelit dhe pasuesve të tij

është rregullimi paqësor i konfliktit mbi bazën e një konsensusi të thirrur në kushtetutën e lirisë. Politika këtu kuptohet si rregullim i përbashkët shoqëror. Shteti drejtohet përmes institucioneve të tij dhe ligjeve. Njerëzit bashkohen dhe krijojnë një akt të tillë juridik në dobi të sigurisë më të madhe fizike të tyre. Përmes kushtetutës organizohet jeta e përbashkët e tyre. E metë e Aristotelit është kufizimi i të drejtës së të qenit të lirë vetëm për një pakicë të theksuar anëtarësh të polisit dhe përjashtimi i të qenit qytetar me të drejta të barabarta për një shumicë absolute të njerëzve (gratë, robërit, shërbëtorët, fëmijët) në polis.

### Etika e pushtetarit

Nocioni mbi politikën i Machiavellit nënkupton etikën e personit të veshur me pushtet. Marrja, mbajtja dhe zmadhimi i pushtetit është për të qëllim i politikës. Morali duhet t'ju nënshtrohet këtyre qëllimeve. Nëse mbrojtja e pushtetit kërkon heqjen dorë të respektimit të moralit, këtë gjë Makiaveli e lejon. Sipas Makiavellit princi duhet të ketë veçoritë e luanit (forcën) dhe të dhelprës (dinakërinë). Atij i interesojnë teknikat e marrjes së pushtetit nga një individ (Princi) dhe lufta kundër kundërshtarëve politikë që synojnë pushtetin. Ai i analizon të gjitha masat që duhet t'i ndërmarrë pushtetari (diplomatiqe, luftarake etj) për të realizuar synimet e tij. Synimi i Makiavellit nuk është bashkëjetesa e harmonishme, por sundimi mbi njerëzit. Këto forma të konceptimit moral janë të njohura edhe në praktikën e sotme politike.

### Etika e baraspeshës në mes të politikës dhe moralit

Kanti e definon politikanin e moralshëm si një njeri, i cili principet e mençurisë shtetërore (gjerm. Staatsklugheit) i kupton si të tilla, që qëndrojnë së bashku me moralin. Parimi i politikanit moral është: në rast të të metave evidente në kushtetutën e shtetit, të cilat shihen se janë pengesë për zhvillim, është detyrë e burrështetasve, që ato të përmirësohen dhe të sillen në akord me të drejtën natyrore, ashtu siç ajo qëndron në idenë e

arsyes: edhe në rast se kjo do të duhej të kushtojë me flajime vetanake pushtetore.

Kanti më tutje konstaton se edhe pse objektiviteti (në teori) nuk ka mosmarrëveshje midis moralit dhe politikës, në rrafshin subjektiv mosmarrëveshja do të mbetet gjithmonë, sepse ajo shërben si gur i virtytshëm, guxim i vërtetë i të cilit nuk është si të kundërshtosh të këqijat dhe sakrificat në mënyrë të vendosur, por të shohësh në sy gënjeshtër dhe pabesinë, si dobësi të natyrës njerëzore.

Duke pasur parasysh këtë Kanti konstaton se politika e vërtetë nuk mund të bëjë asnjë hap pa i bërë homazhe moralit.

### Etika e frymës objektive

Hegeli shkruan se 'moral i një shteti është realizimi i frymës/shpirtit objektiv'.

Ajo sipas Hegelit nuk kuptohet në mënyrë apriori, por nga pikëpamja e të vërtetës historike. Hegeli synon krijimin e shtetit moral. Dhuna shtetërore konsiderohet nga Hegeli si një sferë e gabimeve. Ajo është dhunë nga ministrat dhe zyrtarët shtetëror. Dhuna e shtetit nuk mund të arsyetohet me pretendimin e interesit të përgjithshëm shtetëror. Në të kundërtën: interesi i shoqërisë qytetare duhet realizuar përmes shtetit moral, me qëllim që qytetarët "ta shohin shtetin si esencë të tyre, pasi që ai i mban sfera të tyre të veçanta, autorizimin dhe autoritetin e tyre".

Në mënyrë dialektike Hegeli na dëshmon se shteti moral nuk mundësohet përmes mohimit të lirisë së qytetarit (privat), por përmes realizimit të kësaj lirie, pasi që vetëm në këtë mënyrë shteti e fiton besimin e individit dhe mund të konsiderohet prej tij si esenca e tij.

### Etika e një rregullimi hipotetik ideal

Marksit e definon politikën si proces të një ndryshimi të përgjithshëm të gjendjes së përgjithshme shoqërore që ka për qëllim krijimin e një shoqërie (ideale) pa klasa. Pra, teoria marksiste i parashtron vetes një qëllim hipotetik: arritjen e një rregullimi ideal. Etika marksiste mund të definohet edhe si etikë e revolucionit dhe veprimit revolucionar. Për t'u realizuar qëllimi i luftës klasore, "likuidimi i armikut klasor", dhe

krijimi i shoqërisë pa klasa, pa konflikte dhe pa sundues lejohet të zbatohen të gjitha mjetet e mundshme, edhe dhuna dhe diktatura e proletariatit.

**Shprishja e politikës**

Ajo që gjermanët e quajnë 'Politikverdrossenheit', të cilën këtu po e përkthejmë si shprishje e politikës, është rrezik për të gjitha shoqëritë. Me shprishje të politikës nënkuptojmë jo vetëm pakënaqësinë masive me politikën ditore, njëjtësimin moral të të gjitha subjekteve politike dhe shoqërore, sipas sentencës "Të gjithë janë njësoj!", zhgënjimin me rendin shtetëror dhe institucionet e tij demokratike. Shprishja e politikës ndodh atëherë, kur është prishur drejtpeshimi i qëndrueshëm në mes të moralit dhe politikës, ose thënë më konkretisht vije deri të zbatimi ekscesiv i politikës dhe lënia anash e së moralshmes. Pajoja të një fenomeni të tillë janë ose apatia politike, refuzimi i gjithë klasës politike ose mësymja drejt formave jodemokratike të veprimit. Një fenomen i tillë paraqitet kur politikanët ndërmarrin veprime politike, të cilat në mënyrë të dukshme, janë ose nënkuptohen si veprime në kundërshtim me bindjet e tyre, të cilat nuk janë të orientuara në dobi të shtetit dhe shoqërisë, janë rezultat i lobingjeve jashtështetërore, ushtrohet presion ndaj aktorëve vendimmarrës (deputetëve, ministrave) dhe sjelljes së pahijshme të aktorëve të caktuar politikë. E keqja është një realitet moral edhe në politikë, e cila duhet pranuar si e tillë. Sokrati mendonte se e keqja në politikë është vetëm padituri. Ne mendojmë se është më shumë se kaq.

**Nevoja për rikthimin e politikës drejt moralit**

Koncepti aristotelian dhe ai kantian në lidhje me raportet në mes të moralit dhe politikës janë me përparësi. Natyrisht duke mënjeluar kufizimet e lartpërmendura aristoteliane për grupe, gjini dhe shtresa të caktuara shoqërore. Duke mos synuar rregullime përfundimtare ideale, as shfrytëzim të çdo mjeti për marrjen dhe ruajtjen e pushtetit, tipi aristotelian i etikës nuk synon të përdorë mjete të paarsyeshme. Ai mbështetet në arsyen dhe vullnetin e mirë të njerëzve. Kanti e ka formuluar ligjin themeltar të arsyes praktike në "Kritikën e arsyes praktike" në këtë mënyrë: "Handle so, daß die Maxime deines Willens jederzeit zugleich als Prinzip einer allgemeinen Gesetzgebung gelten könne". (Vepra në atë mënyrë, që maksima e vullnetit tënd të mund të vlejë në çdo kohë si një princip i ligjëvënies së

përgjithshme"). Ky është imperativi kategorik, që mund të rregullojë raportet e drejta në një shoqëri të lirë dhe demokratike. Ky është imperativi kategorik të cilit duhet përmbajtur politika dhe shoqëria për të vënë një drejtpeshim të qëndrueshëm në mes të politikës dhe moralit. Më tutje nuk ka nevojë të shkohet. Konceptimi bashkëkohor etik parashtron edhe nevojën e marrjes së përgjegjësive për veprim. Sidomos është i rëndësishëm skepticizmi pozitiv në institucionet politike dhe normat e aprovuara prej tyre. Qytetari bashkëkohor duhet ta ketë një dozë mosbesimi vazhdimisht: sepse ajo determinon kontrollimin e pushtetit dhe të pushtetarëve. Institucionet e shtetit kanë nevojë për instanca kontrolli dhe ndarje të pushtetit: legjislativ, ekzekutiv dhe judikativ. Kjo ndarje nuk guxon të jetë vetëm formale, por reale. Skepticizmi jo vetëm e mbron qytetarin nga padrejtësitë, që pushtetarët mund "të mos i shohin", por edhe e ndihmojnë pushtetarin të qeverisë drejt nga frika e mosvotimit të sërishëm. Këta mekanizma, që në dukje mund të paraqiten si konflikt-tuoz, në të vërtetë luajnë rol mbrojtës dhe korrigjues. Politika etike bashkëkohore nuk flet sot vetëm për përgjegjësinë, por edhe për ndërgjegjen, dhënien e llogarisë institucionale dhe mirëqenien sociale. Mungesa e së moralshmes në politikë krijon anarki morale dhe shumë të panjohura dhe të papritura në shoqëri. Politika duhet rishqyrtuar vazhdimisht raportin e saj me moralin. Ajo duhet rikthyer drejt moralit. Politika nuk duhet të ketë drojë që t'i rikthehet së moralshmes, për të vendosur baraspeshën e qëndrueshme në mes të moralit dhe politikës. Janë një numër përcaktimesh morale, të cilat kanë vlerë absolute në politikë: mbajtja e premtimit, shmangia e gënjeshtërisë dhe mashtrimit, konsensusi për tema të interesit nacional, respektimi i raporteve reale që sjell rezultati zgjedhor, ruajtja e sistemit të vlerave kombëtare, ndarja e pushtetit konform shkallës së mbështetjes nga zgjedhësit etj. Për këto premisa nuk vlen më shumë se sa mendja e shëndoshë njerëzore do të thoshte Kanti. Shoqëria demokratike ka nevojë për moral në politikë, për qetësi, për respekt të ndërsjellë. Politika ka një kuptim dhe një qëllim. Qëllimi i saj është garantimi i të drejtave të njeriut, të secilit njeri veç e veç, luftimi i varfërisë, evitimi i konfliktit dhe mirëqenia. Krijimi i një shteti të mirëqenies sociale mbetet edhe më tutje një qëllim dhe orientim i mendjes politike.

**(Ligjëratë e mbajtur në Bibliotekën e qytetit "Hivzi Sylejmani" në Prishtinë, organizuar nga Klubi i Librit, Virtual Sophists dhe Filozofia.al)**



**Delawie: ShBA-ja do t'i ndihmojë komunat për realizimin e projekteve**

**GJAKOVË, 16 PRILL (ER)** - Ambasadori amerikan në Kosovë, Greg Delawie, ka vizituar të hënën Komunën e Gjakovës, ku është pritur nga kryetari Ardian Gjini. Në këtë takim kryetari Gjini ka informuar ambasadorin amerikan lidhur me projektet që tashmë kanë filluar si dhe për planin katërvjeçar të punës së Komunës së Gjakovës. Ambasadori Delawie ka theksuar se shteti amerikan gjithmonë do të japë ndihmën e pakursyer në projektet për zhvillimin e komunave.

**Ngrihet aktakuzë ndaj tetë personave për përfshirje në grup kriminal**

**FERIZAJ, 16 PRILL (ER)** - Prokuroria Speciale e Kosovës pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj ka ngritur aktakuzë ndaj disa personave, të cilët akuzohen se kanë kryer veprat penale "pjesëmarrje në organizatë kriminale" dhe "blerje dhe shitje të pautORIZUAR të narkotikëve". Sipas njoftimit për media, Prokuroria Speciale i akuzon A. L., R. H., E. G., E. A., G. A., se kanë kryer veprat penale "pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar" lidhur me veprën penale "blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge".



Sipas këtij njoftimi, një nga të akuzuarit gjendet në arrati dhe kundër tij janë pezulluar të gjitha hetimet. Kurse kundër tre

personave të tjerë me inicialet Z. B., L. N. dhe E. S., Prokuroria Speciale ka ngritur aktakuzë për veprën "dhënia e ndihmës kryerëse pa kryerjes së veprës penale". Siç njofton Prokuroria, ky grup i organizuar dyshohet se nga muaji shkurt 2017 deri më 30 prill të po këtij viti ka bërë blerjen, transportin dhe shitjen e substancave narkotike. Policia në Ferizaj, në prill të 2017-s, kishte sekuestruar 824 kilogramë narkotik të llojit marjhanë. Kjo është sasia më e madhe e narkotikëve të sekuestruar nga autoritetet në Kosovë.



**Bashkatdhetari Besnik Ademi dhuron 30 kompjuterë për shkollat e Klinës**

**KLINË, 16 PRILL (ER)**- Bashkatdhetari dhe veprimtari Besnik Ademi nga fshati Poterq i Komunës së Klinës, i cili jeton në Zvicër, ka dhuruar 30 kompjuterë për tri shkolla të kësaj komune: shkollës së Zllakuqanit, të Jagodës dhe të Poterqit, me qëllim të pajisjes së kabineteve të teknologjisë

informative të këtyre shkollave. Kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, ka falënderuar Ademin, duke theksuar se kontributi i komunitetit tonë në diasporë nuk ka munguar asnjëherë. "Ne ju jemi mirënjohës ju veprimtarëve dhe humanitarëve të mërgatës sonë në përdorim për gjithçka çfarë

keni bërë për vendlindjen dhe atdheun. Edhe gjatë okupimit, por edhe pas mbërritjes së frymës së lirisë në Kosovë, ju keni ndihmuar vendlindjes dhe atdheun tuaj në shumë fusha të jetës, sidomos në fushën e arsimit, si segmenti më rëndësishëm i shoqërisë", ka thënë Elezaj.

## May i drejtohet Parlamentit lidhur me sulmet në Siri

**LONDËR, 16 PRILL** - Kryeministria e Britanisë së Madhe, Theresa May, të hënën është përballur me ligjvënësit britanikë. Ajo ua ka shpjeguar atyre vendimin për të kryer sulme ajrore në Siri, pa miratimin e Parlamentit.

Britania, Shtetet e Bashkuara dhe Franca të shtunën kanë goditur caqe në Siri, në përgjigje ndaj një sulmi të dyshuar kimik në Duma, ku u vranë dhjetëra persona. Parlamenti britanik rifillon të hënën punën, pas pushimit pranveror. Ligjvënësit nuk

janë konsultuar para sulmit në Siri, raporton "AP". Qeveria britanike, megjithatë, ligjërisht nuk është e obliguar të marrë miratimin e Parlamentit për sulme ajrore, por rëndom për veprime të tilla merr qëndrimin e ligjvënësve.



# Trumpi do tërheqjen e trupave nga Siria

Zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Sarah Huckabee Sanders, tha se misioni amerikan nuk ka ndryshuar dhe presidenti Trump ka qenë i qartë se dëshiron që forcat amerikane të kthehen në atdhe sa më shpejt të jetë e mundur

**UASHINGTON, 16 PRILL** - Shtëpia e Bardhë thotë se presidenti Donald Trump vazhdon të jetë i vendosur për tërheqjen e forcave amerikane që ndodhen në Siri. Të hënën presidenti francez Emmanuel Macron tha se e pati bindur presidentin Trump t'i mbante njësitë amerikane në Siri. Ministrat e jashtëm të Bashkimit Evropian kanë diskutuar të hënën në Luksemburg për sulmet ajrore, ndërkohë që diskutime zhvillohen edhe në Paris në një seancë të parlamentit francez. "Misioni amerikan nuk ka ndryshuar. Presidenti ka qenë i qartë se dëshiron që forcat amerikane të kthehen në atdhe sa më shpejt të jetë e mundur", deklaroi zëdhënësja e

Shtëpisë së Bardhë, Sarah Huckabee Sanders. Ajo shtoi se ShBA-ja dëshiron shkatërrimin e plotë të grupit militant Shteti Islamik dhe se po punojnë për ta parandaluar rikthimin e tij. Macron foli më herët, për kanalin francez BFM, dy ditë pasi Franca iu bashkua sulmeve ajrore të ShBA-së dhe të Britanisë ndaj infrastrukturës siriane të armëve kimike. "Dhjetë ditë më parë presidenti Trump tha se Shtetet e Bashkuara duhet të tërhiqen nga Siria. E bindëm se ishte e nevojshme të qëndrojmë për një periudhë afatgjatë. E bindëm se duhet të kufizoheshin sulmet vetëm ndaj objekteve të armëve kimike pasi, siç e dini, pati reag-



ime pas mesazheve në "Twitter", tha Macroni. Udhëheqësi francez tha se ka prova që Qeveria siriane përdori gaz helmues në qytetin Douma dhe se sulmet ajrore ishin të nevojshme për t'ia dhënë

besueshmërinë komunitetit ndërkombëtar. I pyetur nga gazetari nëse mendon se rusët janë bashkëfajtorë, Macroni u përgjigj se "sigurisht që ata janë". Ai shtoi se i ka thënë edhe presidentit rus,

Putin, se, megjithëse ata vetë nuk përdorën klorin, ata kanë shkakuar në mënyrë metodike paafësinë e komunitetit ndërkombëtar për të vepruar me mjete diplomatike për ta ndaluar përdorimin e armëve kimike.

# Qëndrimi i ashpër i Merkelit ndaj Rosisë has në rezistencë

**BERLIN, 16 PRILL** - Ministri për Çështje Evropiane i Gjermanisë, Michael Roth, ka bërë thirrje të hënën për një politikë të re për ulje të tensioneve me Rusinë, duke shtuar një reagim më shumë drejt kancelares gjermane Angela Merkel për ta moderuar qëndrimin e ashpër ndaj Kremlinit, transmeton "Reuters".

Kancelarja konservatore ka mbështetur Britaninë pas helmimit të ish-spiunit rus,



Sergei Skripal dhe vajzës së tij Yulia në Sallsbëri, duke dëbuar katër diplomatë rusë pavarësisht se klasa politike e sheh me dyshim konfrontimin e Gjermanisë me gjigantin lindor. Ministri Roth, njëherësh anëtar i Partisë Social-Demokrate (SPD), ka thënë se derisa Bashkimi Evropian duhet të ketë një qëndrim të përbashkët ndaj Rosisë, sanksionet duhet të kenë qëllim dërgimin e Moskës në tavolinën e negoci-

atave. Shumë shtete perëndimore janë duke bërë presion për një qasje më kritike kundër Moskës, pasi presidenti rus, Vladimir Putin, vazhdon ta mbështesë presidentin sirian Bashar al-Assad, i cili akuzohet për përdorimin e armëve kimike në luftën shtatëvjeçare në Siri.

Tonet e Merkelit ndaj Rosisë janë ashpërsuar sidomos pas vendimit të Moskës për ta aneksuar Krimenë nga Ukraina.

## Duma ruse konsideron sanksione hakmarrëse kundër ShBA-së

**MOSKË, 16 PRILL** - Dhoma e Ulët e parlamentit të Rosisë ka planifikuar leximin e parë të një Projektligji lidhur me masat hakmarrëse kundër Shteteve të Bashkuara më 15 maj. Ligjvënësit janë takuar më 16 prill rreth planeve për ta goditur Uashingtonin, i cili 10 ditë më parë ka urdhëru-

ar ngrirjen e aseteve dhe kufizimeve financiare për manjatët, zyrtarët e sigurisë, politikanët dhe kompanitë që shihen si të afërta me presidentin rus, Vladimir Putin.

Sekretari i Thesarit amerikan, Steven Mnuchin, ka thënë se sanksionet janë përgjigje për

"aktivitetet e dëmshme të Rosisë në botë".

Projektligji rus, i prezantuar më 13 prill për t'i luftuar "hapat armiqësorë të Shteteve të Bashkuara dhe shteteve të tjera", do ta autorizonte qeverinë e Putinit për të ndaluar apo kufizuar importin e mallrave dhe

shërbimeve amerikane.

Zëvendëskryesuesi i Dumës, Aleksandr Zhukov, ka thënë më 16 prill se një grup i ligjvënësve dhe ekspertëve do ta diskutojnë projektligjin më 3 maj. Rusia ka kritikuar ashpër sanksionet e reja amerikane.

Zëdhënësi i Putinit, Dmitry



Peskov, i ka cilësuar të njëjtat si "asgjë më shumë se grabitje të pronës ndërkombëtare".

Një vepër studimore që e nderon shkencën e albanologjisë - (Vebi Bexheti, "Magjia e fjalës poetike", Tetovë, 2018)

## Kur dhembja e individit bëhet frymë e qëndresës kombëtare



**Prof. dr. Emin KABASHI**

Studiuesi, prof. dr. Vebi Bexheti, në veprën studimore "Magjia e fjalës poetike", duke u marrë me tema dhe motive të veçanta të poezisë shqipe, lëndë që e njeh prej vitesh, që e ka ligjëruar para shumë brezave të studentëve shqiptarë, ka qëmtuar specifikat e dhembjes në poezinë e vëllimit "Lum Lumi" të Ali Podrimës. Por, brenda kësaj dhembje, ka shpaluar edhe frymën e madhe të qëndresës shqiptare, jo vetëm kundër robërisë, jo vetëm kundër pushtimit, por ruajtjen e idealit për tërësinë e atdheut, pra të bashkimit kombëtar.

Ky përkufizimi, më thotë mendja u shkon për shtati edhe studimeve të tjera të Vebi Bexhetit të përfshira në këtë vepër. Secili nga studimet e tij, qoftë ai që i kushtohet poezisë së Azem Shkrelit, "Pesha e fjalës poetike e Azem Shkrelit", ku ka gjetur aspekte specifike të poezisë së tij, duke e cilësuar drejtë dhe saktë, se poezinë e tij e karakterizon pesha e fjalës, pra Fjala poetike, e thënë aq me kursim, e në të njëjtën kohë me aq peshë kuptimore. Figurat, kryesisht figura të mendimit, që janë veçori e poezisë moderne, edhe asaj shqiptare, janë një çështje tjetër të cilat i ka marrë në shqyrtim studiuesi Vebi Bexheti, në këtë studim për poezinë e Azem Shkrelit.

Po ashtu, edhe kur ka shqyrtuar e analizuar anë të veçanta të poezisë së poetit Din Mehmeti, studiuesi ka gjetur një të përbashkët të poezisë së tij, qoftë edhe duke huazuar ndonjë varg nga krijimtaria e poetit. Jo, rastësisht, andaj shqyrtimin për poezinë e tij e ka përkufizuar: "Din Mehmeti, poeti që i armatos vargjet poetike". Qoftë edhe vetëm përkufizimi i këtyre, flet qartë për interesimin e studiuesit, për aspektet që ka analizuar, për vargjet që i kanë lënë më shumë mbresa dhe i kanë zgjuar meditime, për cilësinë e vargut poetik, por edhe për sakrificimin e kësaj cilësie, në shërbim të lirisë së atdheut. Të gjitha këto plane shqyrtimi për poezinë e Din Mehmetit, janë artikuluar edhe me vargje nga krijimtaria e tij, edhe me ilustrime, për ta mbështetur

edhe mendimin, edhe ndjeshmërinë e tij, për akëcilin aspekt të poezisë së Din Mehmetit, por që në taban e ka armën për lirinë e kësaj pjese të atdheut.

Poeti Din Mehmeti, sipas studiuesit, i është dashur vetëm përdorimi në shumës i Komandantit Legjendar Adem Jashari, për të përgjithësuar, jo vetëm sakrificën e tij, por edhe për të shpaluar përmasën kombëtare të sakrificës kolektive, duke filluar nga Komandanti, nga familje e deri të atdheu. Titulli i poezisë "Adem Jasharët", dëshmon saktë shtresimin e figurës poetike, që shkon nga e veçanta te e përgjithshmja. Ky është tabani, ku i ka armatosur vargjet Din Mehmeti, andaj studiuesi ka shpaluar këtë aspekt të poezisë së tij, si një temë dhe motiv shumë i veçantë në tërë poezinë shqipe.

Në këtë hulli është trajtuar edhe poezia e Murat Isakut, një krijues tjetër i poezisë shqipe, nga një krah tjetër i zhvillimit të kësaj letërsie, në kushte robërie dhe pushtim tragjik. Andaj, studiuesi ka gjetur të qëlluar përkufizimin kur fletë për poezinë e Murat Isakut: "Poezia e vendlindjes dhe e fatit të fisit e Murat Isakut".

Studiuesi Vebi Bexheti, fillimisht, duke shqyrtuar veprën letrare, sidomos veprën poetike të Murat Isakut, ka prekur edhe rrethanat historike në të cilat është zhvilluar edhe letërsia shqipe, sidomos poezia shqipe, edhe në pjesët e pushtuar të atdheut. Konstatimi i tij se kjo letërsi, pra letërsia shqipe ka pasur zhvillim të ndryshëm në Shqipëri, andaj edhe në Kosovë e në Maqedoni, si dhe në mërgatën shqiptare, sa ndonjëherë as që e kanë njohur krijimtarinë e njëri-tjetrit, qoftë edhe krijuesit e të njëjtit brez.

Poeti Murat Isaku, duke u marrë me vendlindjen, doemos është marrë edhe me udhën e madhe të historisë së fisit, pra të popullit, që nga lashtësia e këndeje. Kjo histori e lashtë, e cila herë vinte e përgjysmuar në kujtesën tonë, herë e shtrembëruar, herë tjetër e ngarkuar nga ideologji të ndryshme, poeti Murat Isaku, ka prekur anë të ndryshme të kësaj kujtese historike, duke ruajtur përherë gjuhën figurative të poezisë, pra të artit të fjalës, sidomos duke i dhënë hapësirë mungesës së madhe të gjurmëve të historisë, që të tjerët, pushtues të ndryshëm kishin bërë përpjekje për ta zhdukur, në mënyrë që brezat e tjerë të fisit të poetit të rriteshin pa këtë anë të vetëdijes së tyre kombëtare. Andaj, në poezinë

"Në asnjë breg", poeti ka shpaluar fuqishëm këtë mungesë, këtë dhembje dhe këtë stërkeqe të historisë: "Në asnjë breg / s'e gjeta gojë [dhënë për të afërmit/ dhe hirin prej rrënjësh në vatrën e të parëve.../ Në asnjë sirtar s'më ranë sy / çelësat e portës së madhe / dhe në asnjë cak nuk e gjeta emblemën e fisit" / . (Cit. V. Bexheti, 248).

Në studimin e tij, "Magjia e fjalës poetike", Vebi Bexheti ka marrë në shqyrtim, edhe çështje të tjera, nga krijues të ndryshëm. Ka analizuar vetëm tri poema të poetit dhe shkrimtarit, po ashtu të njohur, Abdylaziz Islamit. Të tri poemat që studiuesi ka marrë në shqyrtim, "Pella(z)gonia", "Pollogu" dhe "Iliriada", i kushtohen lashtësisë, që nga koha para ilire e deri në ditët e kësaj Maqedonie, që përgjysmonte pjesën e popullit shqiptar, me të gjitha mjetet e mundshme, ligjore e joligjore, vetëm që ata të ishin zot në ato toka, edhe pse e dinin se Qendrat e vendosjes evropiane ju kishin dhënë, pasi kishin copëtuar gjeografinë e shtetit shqiptar të 1912-s.

Një studim krejt i veçantë, për një krijuese, po ashtu shumë të veçantë, Vebi Bexheti ia ka kushtuar poezisë së poeteshës Lindita Ahmeti. Poezia e saj është e veçantë, edhe për faktin se motivet që trajton, temat që merr për frymëzim në poezinë e saj, në punë të ndërtimit poetik, kanë veçori karakteristike, ku shpërfaqet dhembja dhe bregja, sidomos për fatin e femrës, veç-

mas për fatin e femrës në trevën ku jeton poetesha, veshur me vellon e njohurive nga lashtësia. Do të thotë, aspektet që ka shqyrtuar studiuesi në poezinë e Lindita Ahmetit, janë tema që në thadrimin poetik, marrin theksime filozofike, sidomos kur trajton, anë të ndryshme të jetës, të dashurisë, të bukurisë, të trishtimit, të vuajtjes dhe të mallëngjimit, siç ka hetuar edhe autori i këtij studimi. (273).

"Poezi me aromën e lules 'Iris Illyrica' të poetes Lindita Ahmeti", e ka përkufizuar studiuesi e tij, prof. Vebi Bexheti. Studiuesi vëren se një veçori e theksuar e poezisë së poeteshës, është frymëzimi nga kujtesa historike për lashtësinë tonë, pra të popullit dhe kombit tonë, por edhe njohja që ajo ka shpaluar nga filologjia klasike greke, ku mbisundojnë gjurmët e trashëgimisë iliro-shqiptare. Qoftë, edhe vetëm për këtë përkufizim karakteristik, studimi i Vebi Bexhetit për poezinë e poeteshës Lindita Ahmeti, katërcipërisht shpalon vlerat themelore të kësaj poezie dhe i bën nder artit të krijueses, në njërin anë, por edhe mendimit kritik të autorit, në anën tjetër.

### Përfundim

Studimin "Magjia e fjalës poetike", studiuesi prof. dr. Vebi Bexheti e përmbyll, të thuash me tri nekrlogji, që në këtë vepër, janë edhe studime me vete. Janë të tillë, sepse ka trajtuar aspekte të krijimtarisë shkencore të

akademikut Jorgo Bullo, ka folur për ikjen e poetit të madh të poezisë shqipe, Dritëro Agolli, si dhe ka marrë në përsiatje, vdekjen thuajse biblike, larg tokës së tij, të poetit Ali Podrimja.

Studimi i Vebi Bexhetit, "Magjia e fjalës poetike", dëshmon për përkushtimin e autorit, jo vetëm në planin e kërkimit të temave për shqyrtim, por edhe për informacionin e duhur shkencor, si dhe për kujdesin në punë të metodologjisë së hulumtimit shkencor, që studimet e tij të jenë bazë e mirë për rrugën e studimeve të ardhshme për poezinë shqipe.

Duke u marrë me krijues të veçantë dhe të ndryshëm, po ashtu duke u marrë, me tema të veçanta, krejt specifike, që janë trajtuar edhe në këtë shkrim analizues, studiuesi Vebi Bexheti, ka dëshmuar njohjen e thellë që ka për poezinë shqipe, të të gjitha periudhave kohore, që ka marrë në shqyrtim, e sidomos artin e poezisë shqipe të krijuar nga arbëreshët tanë.

Qoftë, vetëm për këto dhe ndonjë karakteristikë tjetër, të studimit të tij, mund të thuhet se vepra studimore "Magjia e fjalës poetike", të studiuesit Vebi Bexheti, i bën nder autorit, i bën nder dijes universitare shqiptare, në fund të fundit, u bën nder studimeve albanologjike.

**(Shënim: Pjesë nga ky shkrim janë lexuar më 10 prill 2018 në Institutin Albanologjik të Prishtinës, me rastin e përfundimit të kësaj vepre studimore. Fund)**



**E jashtëzakonshme**

# Hoteli si burg, nata kushton 107 dollarë

Qytetarët që respektojnë ligjin kanë mundësi të përjetojnë qoftë një herë të vetme në jetë të qëndrojnë prapa hekurave. Këtë ua mundëson një hotel, Penny Rope Bed Chambe në Margate, Kent që ka krijuar dhoma të

posaçme burgu për këdo që dëshiron ta provojë këtë përvojë. Një natë në dhomën e hotelit do t'ju kushtojë 107 dollarë. Dhomat, duke përfshirë edhe dyert, kanë karakteristikat e një qelie burgu tradicionale.



**FOTO E DITES**



Një qytetare proteston pranë Parlamentit në Nju Delhi kundër dy rasteve të femrave të përdhunura kohët e fundit në Indi. /AP/

**E rrallë**

# Bie në pus elefanti, i gjithë fshati angazhohet për shpëtimin e tij

Një elefant i vogël ka rënë brenda një pusi në përpjekje për të pirë ujë. Rënkimet e katërmujshit për ndihmë u dëgjuan nga banorët e zonës të cilët e gjetën në një thellësi prej 1.8



metrash brenda pusit në Ampara, Sri Lanka. Një ekip shpëtimi erdhi në vendngjarje pasi fshatarët lëshuan alarmin.

**BARSOLETA E DITËS**

**Profesori dhe nxënësi:**  
**Profesori:** Ti mund të mësosh, por s'po do.  
**Nxënësi:** Edhe ti mund të ma lësh dysh, por s'po do.

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Vetem gjatë vikendit në ora 14:30**

**“BLACK PANTHER”**  
**3D (PG-13)**  
 Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.  
 Regjia: Ryan Coogler

**Në ora 17:00**

**“PETER RABBIT”**  
 I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.  
 Regjia: Will Gluck

**Në ora 19:00**

**“PACIFIC RIM UPRISING” (PG-13)**  
 Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.  
 Regjia: Steven S. DeKnight

**Në ora 21:00**

**“RED SPARROW” (R)**  
 Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Schoenarts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.  
 Regjia: Francis Lawrence

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

<p><b>DASHI</b> Edhe pse një pjesë e juaja sot i është përkushtuar karrierës, pjesa tjetër do vetëm qetësi. Jeni në dyluftim me veten.</p>	<p><b>DEMI</b> Miq të janë ata që mund t'i vlerësojnë më mirë veprimet tuaja. Mos u mërzisni sot nëse ju kritikojnë në një situatë të caktuar.</p>	<p><b>BINJAKËT</b> Edhe pse eprorët tuaj ju vlerësojnë, përsëri nuk ndiheni të kompensuar nga ana materiale. Mbase është koha të kërkonti një rritje të rrogës.</p>	<p><b>GAFORRJA</b> Sot ndiheni shumë mirë për sa i përket aspektit të ndjenjave. Diçka e re që sapo ka lindur po ju zë gjithë kohën tuaj dhe mendimet.</p>	<p><b>LUANI</b> Sot mund të ndiheni të privilegjuar për sa iu përket financave dhe do të shpenzoni për një dhuratë personit të dashur.</p>	<p><b>VIRJËRËSHA</b> Jeni shumë të vendosur t'i shkoni deri në fund një projekti personal, edhe pse nuk do të keni mbështetje do t'ia dilni mbanë.</p>
<p><b>PESHORJA</b> Megjithëse energjia nuk ju mungon, sot do ta ndieni veten të plogësht. Do ta kërkonti qetësinë dhe rehatinë e shtëpisë.</p>	<p><b>AKREPI</b> Sot jeni të përqendruar tek çështjet e zemrës. Çdo gjë tjetër do të kalojë në plan të dytë për ju.</p>	<p><b>SHIGJETARI</b> Keni dëshirë për gjëra të bukura dhe shoqëri të mirë sot. Do t'ju mjaftonte prania e miqve për të qenë rehat me veten.</p>	<p><b>BRICJAPI</b> Sot jeni gati për të ikur kudo ku mund të shpëtoni nga streset e ditës. Do ta kërkonti shoqërinë e partnerit sot.</p>	<p><b>UJORI</b> Sot çdo gjë është fokusuar tek financat për ju. Borxhe që do t'ju kthehen dhe shpenzime që nuk i kishit menduar që duhet t'i bëni.</p>	<p><b>PESHQIT</b> Jeni të ndjeshëm dhe pak melankolik sot. Kujtime të vjetra ju sjellin nostalgji për vende të caktuara.</p>

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT Pilkington  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

SHREWSBURY - CHARLTON

1

ROCHDALE - OLDHAM

1

EXETER - CHESTERFIELD

1

## Besa nuk largohet nga Superliga

Mërgim Rexhaj ka parashikuar se Besa është favorite ndaj Flamurtarit dhe Vllaznisë së Pozharanit për ta siguruar pozitën e barazhit. "Ne jemi duke e marrë secilën ndeshje me seriozitet të madh dhe mendoj se kemi përparësi ndaj Flamurtarit dhe Vllaznisë për shkak të orarit, por edhe që luajmë ndaj Flamurtarit në Pejë. Besoj se me angazhimin maksimal të të gjithë lojtarëve do ta arrijmë pozitën e barazhit, pastaj besoj do ta sigurojmë edhe mbijetesën në ndeshjen e barazhit", ka thënë Rexhaj

**EPOKA E RE****Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 16 PRILL** - Një nga lojtarët më të mirë që ka aktualisht Besa e Pejës, Mërgim Rexhaj, ka thënë të hënën për "Epokën e re" se kjo skuadër nuk do të largohet nga Vala Superliga e Kosovës në futboll. Ai ka shprehur optimizëm se skuadra pejane fillimisht do ta sigurojë pozitën e barazhit, pastaj edhe mbijetesën. "Ne jemi duke e marrë secilën ndeshje me seriozitet të madh dhe mendoj se kemi përparësi ndaj Flamurtarit dhe Vllaznisë për shkak të orarit, por edhe që luajmë ndaj Flamurtarit në Pejë. Besoj se me angazhimin maksimal të lojtarëve do ta arrijmë pozitën e barazhit, pastaj do ta

sigurojmë edhe mbijetesën në ndeshjen e barazhit", ka thënë Rexhaj, i cili ka shprehur bindjen se skuadra pejane nuk e ka merituar pozitën nëpër të cilin po kalon. "Sigurisht se është mëkat i madh që një ndër klubet më të suksesshme në Kosovë të luftojë për mbijetesë e jo për titull, mirëpo kjo u ndodh edhe ekupeve të mëdha evropiane e përgjegjësini për këtë duhet ta mbajnë ata të cilët e sollën klubin në këtë gjendje të mjerueshme", ka deklaruar ai. Në xhiron



## Llapi - Drita, derbi i javës së 28

Është caktuar orari i ndeshjeve të javës së 28 në Vala Superligën e Kosovës, ku dy ndeshje do të luhen të shtunën, kurse katër të tjera të dielën. Po të mërkurën do të luhen ndeshjet gjysmëfinale të Digitalb Kupës së Kosovës, ku Vushtrria e sfidon Prishtinën, kurse Vëllaznimi luan ndaj Drenicës.

**Vala SUPERLIGA - Java e 28**

**Më 21 prill takohen:**  
Gjilani - Trepça '89  
Feronikeli - Liria

**Më 22 prill takohen:**  
Llapi - Drita  
Vllaznia - Prishtina  
Besa - Drenica  
Flamurtari - Vëllaznimi

e radhës Besa e pret Drenicën në stadiumin "Shahinaxhiislami", kurse mbrojtësi Rexhaj kërkon maksimumin e pikëve ndaj ish-skuadrës së tij. "Ndeshja e radhës mund të cilësohet për ne një nga ndeshjet më të rëndësishme të sezonit, sepse me fitoren eventuale do të mbajmë diferencë pikësh ndaj Flamurtarit dhe Vllaznisë. Do të jetë një ndeshje mjaft e vështirë duke i ditur

cilësitë e skuadrës së Drenicës, por me angazhimin tonë maksimal besoj se do t'i arrijmë pikët maksimale të dielën dhe të vazhdojmë drejt synimit tonë, që është sigurimi i pozitës së barazhit, pastaj mbijetesës", ka shtuar ai. Skuadra e Besës aktualisht renditet në pozitën e dhjetë me vetëm 18 pikë, ku nga 27 ndeshje ka regjistruar 5 fitore, 3 barazime dhe 19 humbje.

## Biraj: Rezultatet në Ligën Ballkanike, historike

Bashkimi humbi në finale të Ligës Ballkanike nga skuadra e Levskit, por Qëndrim Biraj është i kënaqur me arritjet në këtë garë nga skuadra prizrenase. "Vetëm fakti se kemi arritur deri në 'Final Four' për neve si ekip realisht ka qenë një sukses i madh", ka thënë Qëndrim Biraj për "Epokën e re"

**EPOKA E RE****Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 16 PRILL** - Kapiteni i KB Bashkimi, Qëndrim Biraj, është i kënaqur me suksesin e arritur nga skuadra prizrenase në Ligën Ballkanike. Bashkimi në finale u mposhtë nga Levski, por Biraj e vlerëson pozitive aventurën e skuadrës nga Kosova në këtë garë mjaft prestigjioze. "Vetëm fakti se kemi arritur deri në 'Final Four' për neve si ekip realisht ka qenë sukses i madh. Në gjysmëfinale e kemi pasur përballë ekipin

më të mirë të pjesës së rregullt të BIBL-it, njëherësh dhe organizatorin e kësaj ngjarje. Në këtë takim jemi llogaritur aut-sajderë, por ndodhi e kundërta falë një paraqitje fenomenale që patëm duke dhenë gjithçka nga vetja dhe duke luftuar e besuar deri në fund në fitore ku dhe e arritëm një gjë të tillë", ka thënë Biraj, duke shtuar se: "Në finale realisht ishim të harxhuar dhe nuk e patëm energjinë dhe forcën për ta përsëritur të njëjtën lojë. Këtë gjendje ekipi i Levskit e shfrytëzoi më së miri dhe arriti të tri-

umfojë".

Për ndeshjen finale ka folur edhe trajneri i Bashkimit, Dragan Radoviç, i cili është më meritor për arritjen deri në finale. "Mendoj se nuk kishim forcë dhe energji të mjaftueshme për të bërë një tjetër befasi. Është vështirë të luash në ndeshje të vështira brenda dy ditësh me një rotacion të shkurtër. Besoj se e kemi dhënë maksimumin dhe nuk mund t'i fajësosh lojtarët për asgjë. I uroj ata për paraqitjen, për luftën që bënë dhe për rezultatit e arritur. Po ashtu, e



uroj Levskin për fitimin e titullit. Mund të them se jam i lumtur me atë që ka treguar skuadra në

dy muajt e fundit gjatë ndeshjeve dhe gjatë seanceve stërvitore", ka thënë Radoviç.

## Sejdiu e favorizon Dritën për titull

**PRISHTINË, 16 PRILL** - Trajneri i njohur në futbollin e Kosovës, Gani Sejdiu, ka thënë se skuadra e Dritës është më afër titullit të kampionit në Vala Superligën e

Kosovës në futboll. "Mendoj se Drita është më afër titullit të kampiones sepse e ka orarin më të favorshëm në ndeshjet e mbetura të këtij sezoni", ka thënë Sejdiu

për "RTKLive". "Titullin e kampionit mund ta vendosë edhe përballja në mes të Prishtinës dhe Dritës. Në rast se kjo ndeshje zhvillohet në kryeqytet, atëherë

edhe gjasat e Prishtinës janë të mëdha", ka deklaruar Sejdiu, i cili gjatë karrierës së vet ka drejtuar Feronikelin, Trepçën, Trepçën '89 dhe Besën e Pejës.



## Shqipëria në tetor, miqësore me Jordaninë

**TIRANË, 16 PRILL** - Pas ndeshjes me Uellsin, më datë 20 nëntor, tashmë është konfirmuar për t'u luajtur miqësorja tjetër nga kuqezinjët e drejtuar prej Christian Panucci. Këtë herë

skuadra jonë kombëtare e futbollit do të përballet me Jordaninë, më 10 tetor, po në stadiumin "Elbasan Arena". Kjo miqësore, sikundër edhe ajo me Uellsin, do të luhet në

periudhën kur zhvillohen sfidat e grupeve për Ligën e Kombeve, duke plotësuar kështu edhe kuadrin e gjashtë ndeshjeve, me katër sfida zyrtare në grupin me tre për-

faqësuese të "Uefa Nations League", si dhe dy ballafaqimet miqësore. Federatat përkatëse kanë gjetur akordin dhe zyrtarizojnë sot zhvillimin e ndeshjes miqësore Shqipëri - Jordani.



# Oladipo dhe Indiana, 'leksion' Clevelandit

**OHIO, 16 PRILL** - Indiana e ka befasuar skuadrën e Clevelandit, duke fituar 98-80 në fushën e skuadrës së Cavaliersit, një ndeshje e dominuar nga basketbollistët miq që, ashtu sikurse kishin premtuar, luajtën për fitore në këto çerekfinale të "play-off"-it. Oladipo ishte magjik në parket, duke realizuar 32 pikë, lider në parket për Indianan, ndërsa për Clevelandin nuk mjaftuan 24 pikët, 10 rebaundet e 12 asistimet e LeBron Jamesit që, edhe pse realizoi një "triple double", nuk u mbështet sa duhet nga skuadra, raporton "Telesport". Pas kohës shtesë fitoi Bostoni, që mundi 113-107 Milwaukeeen, ndeshje me rivalitet dhe emocione, ku të dyja ekipet luftuan fort për fitoren. Katër lojtarë të Bostonit realizuan mbi 20 pikë, me Horfordin që ishte më i miri, autor i 24 pikëve e 12 rebaundeve, mbështetur nga Rozieri me 23 pikë, Morrissi me 21 dhe Browni me 20 pikë. Nuk ka surpriza në Perëndim, ku fitojnë ekipet vendëse. Oklahoma mundi 116-108 Utah Jazzin, ndeshje e dominuar nga vendësit, me Georgen që realizoi 36 pikë, më i miri në fushë,



ndërsa Westbrook realizoi 29 pikë e 13 rebaunde. Vuan disi, por në fund triumfon edhe skuadra e Houstonit, që imposhti 104-101 Minnesotën,

ndeshje e hapur dhe emocionuese. I zakonshmi Harden realizoi 44 pikë, duke qenë vendimtar për teksanët në këtë sfidë.

### KONFERENCA E LINDJES

1-8, Toronto - Washington  
2-7, Boston - Milwaukee  
3-6, Philadelphia - Miami  
4-5, Cleveland - Indiana

1-0 me ndeshje  
113-107  
(1-0 me ndeshje)  
80-98

### KONFERENCA E PERËNDIMIT

1-8, Houston - Minnesota  
2-7, Golden State - San Antonio  
3-6, Portland - New Orleans  
4-5, Oklahoma - Utah Jazz

104-101  
(1-0 me ndeshje)  
(0-1 me ndeshje)  
116-108

# Zidane: Isco mendon se nuk e vlerësoj

**MADRID, 16 PRILL** - Zinedin Zidane i ka thurur elozhe mesfushorit Isco, duke thënë se është një lojtar shumë i rëndësishëm për skuadrën e Real Madridit. Trajneri francez ka thënë se Isco mendon se nuk vlerësohet nga ai. "Unë e kam thënë gjithmonë se Isco është një lojtar i rëndësishëm dhe i vlefshëm për skuadrën tonë. Ai këtë vit ka luajtur më shumë sesa vjet. Jam i kënaqur me faktin që shënoi gol sepse e meritonte. Ndonjëherë i shkon ndërmend se unë nuk e vlerësoj dhe nuk e dua", ka thënë Zidane, i cili më pas foli edhe për sulmuesin Karim Benzema që nuk po arrin të shënojë. "Benzema? Do t'i kishte pëlqyer të shënonte, por duket se



këtë vit e ka të vështirë ta gjejë rrjetën. Skuadra reagoi mirë pas ndeshjes në mesjavë në

Ligën e Kampionëve dhe punoi në shumë situata të ndryshme", ka shtuar Zidane.

## SHKURT

### Dorëhiqet Kokollari

Gëzim Kokollari ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit të Bordit në Federatën e Hendbollit të Kosovës (FHK). Ai ka falënderuar presidentin e kësaj federate, Eugen Saraçini dhe anëtarët e Bordit për bashkëpunimin korrekt gjatë punës së përbashkët. "Për shkak të obligimeve të mia ndaj vendit të punës dhe angazhimeve politike, edhe të krijuhet hapësirë e angazhimit te kryesia e re në klubet dhe hendbollin ferizajas, mendoj se lirimim nga obligimet ndaj FHK-së do të ishte kontribut për avancimin e hendbollit të Kosovës", ka thënë Kokollari.

### Gotze rrezikon Botërorin

Mario Gotze po kalon një moment të vështirë në karrierën e tij. Heroi i Kupës së Botës në Brazil rrezikon të lihet jashtë listës së lojtarëve të grumbulluar për në Rusi. Mario ka humbur shkëlqimin dhe nuk po gjen formën e mëparshme pas diagnostikimit me problemet hormonale që kishte. Gotze nuk po luan rregullisht me Borussia Dortmundin dhe nuk ka qenë asnjëherë deciziv për verdhezinjtë.

### Roma "blindon" Alisonin

Presidenti i AS Roma, James Pallotta, menjëherë pas derbit të kryeqytetit italian, ka folur për të ardhmen e portierit brazilian Alisson Becker. Ai i ka siguruar tifozët se portieri në fjalë nuk do të largohet nga "Olimpico". "Nuk e kuptoj përse vazhdoni të më pyesni në lidhje me të. Nuk kemi asnjë qëllim për ta shitur Alison. Kur e morëm te Roma mendonim se ishte një portier i madh dhe, mesa duket, kishim të drejtë, nuk ka asnjë mundësi që ai të largohet", ka thënë Pallotta.

### Vidal mungon ndaj Realit

Tashmë është zyrtarë. Arturo Vidal nuk do të jetë i gatshëm për ndeshjen kundër Realit të Madridit në Ligën e Kampionëve, pasi është lënduar të dielën në stërvitje. "Vidal do të operohet. Ai ka pësuar një ndrydhje të gjurit pa u futur në asnjë kontakt me shokët", ka thënë Jupp Heynckes.

### Fowler: Salah, kandidat për 'Topin e Artë'

Legjenda e Liverpoolit, Robbie Fowler, beson se Mohamed Salah është kandidat serioz për ta fituar "Topin e Artë" dhe çmimin nga FIFA "The Best", ku kanë dominuar Lionel Messi e Cristiano Ronaldo. "Salah meriton të jetë në mesin e më të mirëve për "Topin e Artë". Nuk po them se do ta fitojë. Në fakt, jam shumë i sigurt se nuk do ta fitojë duke parë se si shkojnë gjërat. Por, po them se ai meriton të jetë atje së bashku me Ronaldon e Messin", ka thënë Fowler për "Daily Mail". "Kur them duke e parë si shkojnë gjërat, mos më keqkuptoni, ata dy janë më të mirët në histori, më të mirët që ka parë bota e futbollit. Ata e bëjnë diferencën dhe dytë kanë më shumë shanse për Kupën e Botës, por deri më tani - Salah i ka arritur ata, pa asnjë dyshim. Ndoshta do të ketë më shumë mundësi për ta fituar çmimin e FIFA-s "The Best", sepse zgjidhet nga trajnerët e përfaqësuesve. Votat për "Topin e Artë" janë nga gazetarët", ka shtuar Fowler.

### Jordan kërkon trajnerin italian për Charlotte

Mosarritja e kualifikimit për në "play-off" ka shtyrë drejtuesit e Charlotte Hornetsit t'i nisin që tani seriozisht përgatitjet për sezonin e ardhshëm. Në fakt, skuadra në pronësi të Michael Jordanit ka vendosur të bëjë një revolucion të plotë. Drejtori i Përgjithshëm Mirch Kupchak ka vendosur që fillimisht ta largojë trajnerin Steve Clifford, ndërsa më parë ka marrë leje nga San Antonio Spurs për ta intervistuar ndihmësin e Gregg Popovichit, Ettore Messina. Italiani prej katër sezonesh është ndihmës i Popovichit në pankinën e Spursit, pas një përvojë të shkëlqyer në Evropë. Në rast se arrihet marrëveshja në mes të palëve, Messina do të jetë i pari trajner joitalian që merr detyrën head coach në NBA. Lajmin që Michael Jordani ka kërkuar këtë lëvizje e ka bërë publik Adrian Wojnarowski për ESPN.





**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada - Government  
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)  
Univerziteteske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)  
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)  
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinički Centar Kosova  
– University Clinical Center of Kosovo  
Sektor i Personelit



Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 13 paragrafi 1 dhe 3 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, (SHSKUK); mbështetur në nenin 62 të Ligjit për Shëndetësi Nr 04/L-125, nenit 10 paragrafi 1.1.8, nenit 13 paragrafi 1 e Statutit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, neni 5 paragrafi 1 dhe 2 e Rregullores Nr. 1003/2016 mbi marrëdhënien e punës; Kërkesës të datës 21.03.2018 Nr 459/2 Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së shpallë:

## KONKURS

Nr	Titulli i punës	Departamenti/Sektor	Nr vende të lira	Plotësim i vendeve të lira të punës me marrëveshje
1	Nutricionist	Sektor i Ushqimit dhe Shërbimit të tij	1	
2	Servuese e ushqimit		2	5

**I. Titulli i punës:** Nutricionist (1 pozitë në QKUK)  
**Orari i punës:** 40 orë në javë (orar të plotë)  
**Koeficienti i pagës:** (8.4)  
**Nëpunësi mbikëqyrës:** Shefit të Sektorit të Ushqimit dhe Shërbimit të tij;  
**Kohëzgjatja:** Kontrata me afat të pa/caktuar  
**Nr.i Referencës:** QKUK – 17/2018-04/3-5

### Detvat dhe përgjegjësitë:

- Përpilon normativin për ushqimin dietal dhe ushqimin standard;
- Përpilon menynë ditore dhe javore për ushqimin dietal;
- Përpilon menynë ditore dhe javore për ushqimin standard;
- Kontrollon dhe asiston gjatë prodhimit të ushqimit dietal dhe standard;
- Kontrollon ushqimin e përgatitur nëse i përgjigjet cilësisë, sasisë dhe llojit konform menysë së caktuar dhe lejon distributimin e tij nëse i përgjigjet standardeve të caktuara dhe normativit;
- Ekzaminon procesin e ushqyerjes dhe lidhjen ndërmjet dietës, sëmundjes dhe shëndetit;
- Ofron këshilla shëndetësore dhe promovon të ushqyerit e shëndetshëm;
- Këshillohet për dijeta të veçanta;
- Mban evidencën ditore, javore dhe mujore për ushqimin e përgatitur;
- Bashkëpunon ngushtë me stafin udhëheqës të kuzhinës dhe jep këshilla profesionale;
- Me kërkesën e udhëheqësit kryen edhe pune të tjera.

### Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale, bazuar në specifikat e institucionit :

- Diplomë Universitare-fakulteti i Inxhinieris së Ushqimit;
- Përvojë pune së paku dy vite
- Certifikatë për nutricion dhe Dietologjisë;
- Të ketë shkathtësi për të krijuar marrëdhënie të mira ndërpersonale;
- Aftësi për të ndihmuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët;
- Të ketë shkathtësi të krijimit të sistemit të raportimit,
- Njohja e gjuhëve zyrtare në përdorim (shqip, anglisht dhe serbo-kroatisht)
- Certifikata e Lindjes – fotokopje dhe
- Letërnjoftimi - fotokopje.

**II. Titulli i punës:** Servuese e ushqimit (1 pozitë në QKUK)  
**Orari i punës:** 40 orë në javë (orar të plotë)  
**Koeficienti i pagës:** (4.0)  
**Nëpunësi mbikëqyrës:** Përgjegjësit të Njësisë  
**Sektor:** Sektor Ushqimit dhe Shërbimit të tij  
**Kohëzgjatja:** Kontrata me afat të pa/caktuar  
**Nr.i Referencës:** QKUK 15/2018-03/2

### Detvat dhe përgjegjësitë:

- Bëni pranimin e ushqimit të gatshëm dhe ushqimit të thatë nga kuzhina qendrore;
- Bëni bartjen e ushqimit deri në vendin e caktuar-kuzhina interne, dhoma të pacientëve;
- Është e obliguar që pacientëve t'i ndajë sasinë/llojin e ushqimit të caktuar sipas kërkesës së Klinikave;
- Bëni shërbimin e ushqimit për çdo pacient;
- Bëni mbledhjen e enëve dhe larjen e enëve;
- Bëni pastrimin e enëve, i rendit deri në përdorimin e ardhshëm;
- Kujdeset për hixhenën e përditshme të inventarit dhe pajisjeve tjera dhe të lokalit-kuzhinës;
- Pranon inventarin dhe tërë garniturën e ushqimit dhe me të ngarkohet materialisht;
- Është përgjegjës për ruajtjen e inventarit dhe pajisjeve tjera.

### Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale, bazuar në specifikat e institucionit :

- Diploma - Shkolla e mesme jo mjekësore;
- Njohuri lidhur me procedurat teknike të servimit të ushqimit;
- Certifikata e lindjes – fotokopje,
- Letërnjoftimi fotokopje,
- E dëshirueshme përvoja e punës;

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

**Konkursi është i shpallur 15 ditë nga dita e shpalljes në njërin nga gazetaret ditore**

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë, Zyra e Sektorit të Personelit në Klinikën e Syve. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentacioni mbi kualifikimin, dëshmi përkatëse për përvojën e punës, si dhe dëshmi tjera të kërkuara në konkursin publik.

✓ Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në tel: 038 500 600 25 15 (Zyra e Sektorit të Personelit), prej orës 8:00-14:00.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada - Government  
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)  
Univerziteteske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)  
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)  
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinički Centar Kosova –  
University Clinical Center of Kosovo  
Sektor i Personelit



Prema članu 8 Zakona, tačka 1 i 2 o Radu br. 03/L-212, član 4, Administrativno Uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o Regulisanje Procedura Konkursa na Javnom Sektoru, člana 13. tačka 1 i 3, Statuta Bolničke Službe i Univerziteteskog Kliničkog Centra Kosova (UBKSK), kao i član 62, Zakona br. 04/L-125, o Zdravstvo, Član 10, tačka 1.1.8, člana 13 tačka 1, Statuta Univerzitetski Klinički Centar Kosova, član 5 tačka 1 i 2, Uredbe o radnom odnosima br. 1003 datum 21.07.2016, i Zahtevi od 24.01.2018 i 21.03.2018, Generalnog Direktora UBKSK, objavljuje

## KONKURS

Br	Naziv rada	Odsjek / Sektor	Br. Prazni radni mesta	Popunjavanje slobodnih radnih mesta po dogovoru
1	Nutricionista	Služba hrane i njena usluga	1	0
2	Servirke za I hrane		2	5

**I. Radno mesto:** Nutricista (1 pozicija Služba za hranu i njene usluge)  
**Radno vreme:** 40 sati nedeljno (puno radno vreme)  
**Koeficijent zarade:** (7.2)  
**Nadzorni službenik:** Shefu Službe hrane i njena usluga u UKCK  
**Trajanje:** Ugovor o vremenskom neograničenju  
**Br. Referentni** UKCK - 17/2018-4/3-5

### Dužnosti i odgovornosti:

- Završava normativ za prehranbeni ishranu i standardne obroke;
- Izrađuje dnevni i nedeljni meni za ishranu;
- Izrađuje dnevne i nedeljne menije za standardne obroke;
- kontrolise i asistira tokom proizvodnje prehranbene i standardne hrane;
- Proverite hranu pripremljenu da u skladu sa kvalitetom, količinom i vrstom u skladu

### standardima i normativa;

- Ispitati proces ishrane i odnos između ishrane, bolesti i zdravlja;
- Pružiti zdravstvene savjete i promovise zdravu ishranu;
- Saveti za specijalne dijetete;
- čuvati dnevne, nedeljne i mesečne dokaze o pripremljenoj hrani;
- i pružite profesionalne savjete;
- Na zahtev lidera obavlja i drugi posao.

### Kvalifikacija, iskustvo, veštine i lične karakteristike, na osnovu specifičnosti institucije:

- Univerzitetska Diploma - Fakultet za prehranbeni inženjering;
- Radno iskustvo najmanje dve godine
- Certifikat o ishrani i dijetetici;
- Posedovati veštine za uspostavljanje dobrih međuljudskih odnosa;
- Sposobnost pomoći i saradnje sa drugima;
- Imaju sposobnost da kreiraju sistem izveštavanja,
- Poznavanje službenih jezika koji se koriste (albanski, engleski i srpskohrvatski)
- Izvod rodnjeni – fotokopije,
- \* Licna karat – fotokopije,

**II. Naziv posla:** Servirka za hranu (1 pozicija u UKCK)  
**Radno vreme:** 40 sati nedeljno (puno radno vreme)  
**Koeficijent zarade:** (4.0)  
**Nadzorni službenik:** Službenik jedinice  
**Sektor:** Hrana i Služba  
**Trajanje:** Ugovor o vremenskom neograničenju  
**Referentni broj:** UKCK - 06/2018-2/4

### Dužnosti i odgovornosti:

- Prijem hrane spremna i suve hrane iz Centralne Kuhinje;
- Čini nosi hranu na mesto određene unutrašnje-kuhinje, sobe za pacijente;
- On je obavezan da izdvoji pacijente u iznosu / vrste hrane koju su klinikama potražnje;
- Pružiti usluge hrane za svakog pacijenta;
- Sakuplja posude i pranje posude;
- Čisti posude, sortira ih za budući upotrebu;
- Zagarantuje dnevne inventar i drugu opremu i posude;
- Prima inventar i postavlja set hrane i materijalno naplaćuje;
- Odgovoran je za skladištenje inventara i druge opreme.

### Kvalifikacije, iskustvo, veštine i lične karakteristike, na osnovu specifičnosti institucije:

- Srednja škola (ne medicinski smer)
- Poznavanje tehničkih procedura za servisiranje hrane;
- Izvod iz matične knjige rođenih - fotokopija,
- Poželjno radno iskustvo;
- \* Lična karat – fotokopije,

**Uslovi za učešće u zapošljavanju:** Svi građani Republike Kosova sa punom kapacitetom da deluju, imaju adekvatno obrazovanje i imaju profesionalnu sposobnost da obavljaju svoje dužnosti imaju pravo da se prijave.

### Konkurs se objavljuje 15 dana od dana objavljivanja u jednom dnevnom listu.

Podnošenje prijave: Prijave su primljene i dostavljene Univerziteteskom kliničkom Centru Kosova u Prištini, Kancelarija Kadrovske Službe u Očnoj klinici. Aplikaciji je proračena dokumentacijom o kvalifikaciji, relevantnim dokazima radnog iskustva, kao i drugim dokazima koji se traže na javnom konkursu.

Zahtjevi poslati nakon poslednjeg datuma neće biti prihvaćeni. Nepotpuni zahtevi će biti odbijeni.

Za detaljne informacije kontaktirajte tel: 038 500 600 25 15 (Služba za osoblje) od 8:00 do 14:00 časova.

Generalnog Direktora UBKSK

Dr. Basri Sejdiu



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Punëve të Jashtme - Ministarstvo Inostranih Poslova - Ministry of Foreign Affairs  
Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme/Odeljenje za Finansije i Opšte  
Usluge/Department of Finance and General Services  
Divizioni për Burime Njerëzore/ Divizija za Ljudske Resurse/Division of Human Resources

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullon Nr. 02/2010 neni 15 paragrafi 2 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Ministria e Punëve të Jashtme, shpall:

## KONKURS

### Një (1) Zyrtar i Lartë i Prokurimit

Departamenti / Zyra: Divizioni i Prokurimit  
Nr. i referencës: **MPJ-DP-001/03**  
Koeficienti: 8

#### Detyrat Kryesore

- Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin objektivave të njësisë; 20%
- Udhëheq grupet punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet dhe kryen detyra të specializuara në fushën specifike si dhe ndihmon stafin tjetër të institucionit në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre; 15%
- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin analizon dhe vlerëson realizimin e objektivave dhe planit të punës të njësisë dhe harton raporte mbi progresin e arritur dhe rekomandon përmirësime nëse kërkohet; 15%
- Siguron që të gjitha kërkesat për prokurim janë në pajtim me legjislacionin dhe rregullat e prokurimit publik; 15%
- Përgatit kontrata dhe siguron që metodat e prokurimit dhe teknikat janë të kuptueshme dhe zbatohen nga ana zyrtare tjerë të prokurimit; 10%
- Përgatit forma dhe procedura standarde, varësisht nga metoda e prokurimit dhe siguron që ftesat për oferta për tenderë dhe dërgimi i tyre është bërë me kohë; 10%
- Siguron mbajtjen e të dhënave detale për të gjithë ofertuesit pjesëmarrës, për veprimet dhe vendimet e marra, si dhe nënshkrimi i komenteve nga secili anëtar; 10%
- Kryen edhe punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkohen kohë pas kohe nga mbikëqyrësi; 5%

#### Shkathësitë e kërkuara

- Të ketë aftësi për të menaxhuar me projekte, aftësi për përmbushjen e punëve të ndërlikuara, punëve të afatizuara dhe aftësi pune në grup;
- Të jetë energjik, të ketë shkathësi të mira ndër njerëzore dhe të jetë i gatshëm të punojë me orar fleksibil pune;
- Nohuri të shkëlqyeshme të punës në fushën e prokurimit;
- Të ketë mëvetësi të shkallës së lartë në punën e tij ose të saj dhe kërkohet që të tregojë shkallë të lartë të iniciativës;
- Atësi të mira komunikimi (të shkrimit dhe atij gojor);
- Të jetë inventiv dhe me vëmendje në detaje;
- Nohuri të mirë të punës me kompjuter në Windows, Outlook, Microsoft Works/Office, dhe Internet, Excel;
- Të jetë komunikativ, i vetëpërmbytur dhe të jetë i aftë që të menaxhojë me kohën dhe punët;
- Të jetë i përgjegjshëm dhe i ndërgjegjshëm;
- Te ketë aftësi për hartimin e kontratave dhe menaxhimin e tyre.
- Përveç gjuhëve zyrtare të Kosovës duhet të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze.

#### Kualifikimet dhe përvoja e punës

- Diploma Universitare, në fakultetin Juridik dhe Ekonomik.
- Tri (3) vite përvojë pune profesionale - përkatëse;

#### Një (1) Zyrtar/e për Arkiv

Departamenti / Zyra: Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme/  
Divizioni për IT dhe Logjistikë  
Nr. i referencës: **MPJ-DITL 001/15**  
Koeficienti: 7

#### Detyrat Kryesore

- Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet me drejtuesin dhe stafin tjetër profesional për zbatimin e detyrave, shërbimeve dhe produkteve përkatëse.
- Siguron sistemimin dhe mbajtjen azhure të lëndëve arkivore, si dhe propozon udhëzues të nevojshëm për funksionimin e arkivit.
- Përcakton në përputhje me ligjin mënyrën e mbajtjes së regjistrit arkivor dhe lëndëve arkivore.
- Siguron që njësitë arkivore të jenë të shënuara me shenjat e përcaktuara sipas rregullave.
- Përkujdeset për afatet e arkivimit të lëndëve, si dhe përgatit lëndët me afat të përhershëm për dorëzim në Arkivin e Republikës të Kosovës, sipas dispozitave ligjore.
- Regjistron të dhënat nga format standarde në bazën kompjuterike të të dhënave dhe kontrollon çdo ndryshim të propozuar për klasifikimin dytësor.
- Ruan në vend të posaçëm disqet me shkresat elektronike dhe shkresat të natyrës "në besim".
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme, kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

#### Shkathësitë e kërkuara

- Njohuri profesionale specifike në fushën arkivimit të dokumenteve;
- Aftësi në zgjidhjen e problemeve për çështjet teknike ose procedurale që dalin nga procesi i punës;
- Aftësia për të organizuar punën e vet dhe për të koordinuar stafin e nivelit administrativ;
- Shkathësi hulumtuese, analitike dhe të vlerësimit të informacionit;
- Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

#### Kualifikimet dhe përvoja e punës

- Dy (2) vite përvojë pune profesionale.
- Diplomë universitare në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, drejtimi Administratë Publike, Juridik, Histori;

#### Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve

Kohëzgjatja e emërimit është pa afat - të përhershme (e karrierës) si dhe kohëzgjatja e periudhës provuese është 12 muaj për pozitën e shpallur me këtë konkurs;

Formularët zyrtar për aplikim merren në Zyrën për Burime Njerëzore të MPJ-së, zyra nr. 04/A, ish- ndërtesa e Eulex-it (ruga Luan Haradinaj p.n.) gjithashtu mund të tërhiqen edhe nga Ueb-Faqja e internetit të MPJ-së.

Aplikacionet e plotësuar së bashku me kopjet e dëshmive për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat dhe Vërtetimin nga Gjykata që personi nuk është nën hetime etj, mund të dorëzohen:

- Drejtëpërdrejtë në Zyrën për Burime Njerëzore të MPJ-së, dhe
- Përmes postës.

Aplikacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i plotësuar gabueshëm, do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk do të merret në konsiderim.

Kandidatët duhet të dorëzojnë aplikacione me të dhëna të sakta. Në rast të mosplotësimit të këtyre kërkesave ose ofrimit të informatave jo të sakta, aplikacioni refuzohet, gjithashtu përdorimi i formularëve jozyrtar rezultojnë në refuzimin e menjëhershëm të aplikimit.

Aplikacionet e pranuar pas afatit të caktuar, konsiderohen të pranueshme nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar (postuar) para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve.

Kohëzgjatja e emërimit-punësimit bëhet në përputhje me LSHCK, në të cilën është e përfshirë periudha e punës provuese prej një (1) viti.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër/ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data: 17.04.2018 deri më 01.05.2018 në ora 16.00.

Për informata shtesë mund të kontaktoni Zyrën e Personelit të MPJ-së, në telefonin: 038 212 191 dhe 038 213 363

Konkursi dhe kërkesa për punësim janë të publikuara edhe në Ueb-Faqen e Ministrisë: [www.mfa-ks.net](http://www.mfa-ks.net)

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë"

"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Punëve të Jashtme - Ministarstvo Inostranih Poslova - Ministry of Foreign Affairs  
Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme/Odeljenje za Finansije i Opšte  
Usluge/Department of Finance and General Services  
Divizioni për Burime Njerëzore/ Divizija za Ljudske Resurse/Division of Human Resources

Na osnovu Zakona o Civilnoj službi Republike Kosovo, i Uredbi o procedurama regrutovanja u Civilnoj službi br. 02/ 2010, član 15. stav 2., Ministarstvo Inostranih Poslova, raspisuje:

## KONKURS

### Jedan (1) Viši Službenik za Nabavke

Departman / Kancelarija: Divizija za Nabavke  
Br. referencë: **MPJ-DP-001/03**  
Koeficient: 8

#### Glavni zadaci

- Sastavlja planove rada u dogovoru sa nadzornikom o sprovođenju određenih zadataka na osnovu objektivna jedinice i daje preporuke u vezi sa realizacijom objektivna jedinice; 20%
- Rukovodi radnim grupama u specifičnoj profesionalnoj oblasti kada se traži, i vrši specijalizovane zadatke u profesionalnoj oblasti, takode pomaže ostalo osoblje institucije u realizaciji njihovih zadataka i odgovornosti; 15%
- U saradnji sa nadzornikom, analizira i ocenjuje realizaciju objektivna i plana o radu jedinice, i sastavlja izveštaje o postignutom napretku, takode preporučuje poboljšanja, ako se traži; 15%
- Osigurava da svi zahtevi za nabavke budu u skladu sa zakonodavstvom i pravilima javne nabavke; 15%
- Priprema ugovore i osigurava da metode nabavka i tehniko budu razumljive i da se sprovede od drugih službenika za nabavke; 10%
- Priprema obrasce i standardne postupke, zavisno od metode nabavke i obezbeduje da ponude za tendere i njihova pošiljka budu izvršene na vreme; 10%
- Obezbeduje čuvanje detaljnih podataka za sve ponuđače koji učestvuju, o preduzetim akcijama i odlukama, kao i potpisivanje komentara od svakog člana; 10%
- Vrši i druge dužnosti u skladu sa ciljem radnog mesta koje se povremeno mogu tražiti od nadzornika; 5%

#### Tražene veštine

- Sposobnost upravljanja projektima, sposobnost ispunjavanja kompleksnih poslova, vršenja poslova na vreme i sposobnost za rad u grupi;

- Biti energičan, imati dobre među-ljudske sposobnosti i biti spreman za rad s fleksibilnim radnim vremenom;
- Odlično poznavanje rada iz oblasti nabavke;
- Imati nezavisnost visokog nivoa u svom radu i traži se da pokaže visok stepen inicijative;
- Dobre veštine komuniciranja (pismeno i usmeno);
- Viti inventivan i pažljiv na detalje;
- Dobro poznavanje rada na kompjuteru u programima Windows, Outlook, Microsoft Works/Office, i Internet, Excel;
- Treba biti komunikativan, uzdržan i sposoban za upravljanje vremenom i radovima;
- Treba biti odgovoran i svestan;
- Sposobnost za izradu ugovora i njihovo upravljanje.
- Sem službenih jezika Kosova, treba imati dobro poznavanje engleskog jezika;

**Kvalifikacija i iskustvo rada:**

- Univerzitetska Diploma, Pravni ili Ekonomski Fakultet.
- Tri (3) godina radnog iskustva – odgovarajućeg;

**Jedan (1) Službenik za Arhivu**

**Departman / Kancelarija: Departman za Finansije i Opšte Usluge/ Divizija za IT i Logistiku**

**Br. reference: MPJ-DITL 001/15**

**Koeficijent: 7**

**Glavni zadaci**

- Razvija i dobija saglasnost o planovima rada i rokovima sa Rukovodiocem i drugim profesionalnim osobljem, za primenu zadataka, usluga i odgovarajućih proizvoda.
- Sistematizuje i ažurira arhivske predmete, i predlaže potrebne uredbe za funkcionisanje arhive;
- U skladu sa zakonom, određuje način održavanja arhivskog registra i arhivskih predmeta;
- Obezbeđuje da arhivske jedinice budu zabeležene sa određenim znakovima prema pravilima;
- Stara se o rokovima arhiviranja predmeta i priprema predmete sa stalnim rokovima za dostavljanje u Arhivi Republike Kosovo, prema zakonskim odredbama.
- Registruje podatke iz standardnih obrazaca u kompjuterskoj bazi podataka i kontroliše svaku predloženu izmenu za sekundarnu klasifikaciju.
- Čuva na posebnom mestu, CD-ove i elektronske spise, kao i spise „poverljive“ prirode.
- Vršiti druge dužnosti u skladu sa zakonima i uredbama koje se povremeno mogu tražiti od nadzornika;

**Tražene veštine**

- Specifično profesionalno znanje iz oblasti arhiviranja dokumenata;
- Sposobnost za rešavanje problema o tehničkim ili procesnim predmetima koji proizilaze iz procesa rada;
- Sposobnost za samoorganizovanje rada i za koordinisanje osoblja administrativnog nivoa;
- Istraživačke i analitičke veštine i procena informacije;
- Poznavanje rada na kompjuteru, programi MS office;

**Kvalifikacija i iskustvo rada:**

- Dve (2) godine profesionalnog radnog iskustva;
- Univerzitetska diploma, Fakultet Društvenih nauka, smer Javne Uprave, Pravni Fakultet, Fakultet Istorije.

**Uzimanje i dostavljanje prijave**

Trajanje imenovanja je na neodređeno – stalno (karijera) a trajanje probnog perioda je 12. meseci, za raspisane pozicije u ovom konkursu;

Službeni obrasci za prijavljivanje se dobijaju u Kancelariji za ljudske resurse MIP-a, kancelarija br. 04/A, bivša zgrada Euleksa (ulica Luan Haradinaj, bb), takođe se može preuzeti sa veb stranice interneta MIP-a.

Popunjeni obrasci za prijavljivanje, zajedno sa kopijama dokaza o neophodnim obrazovnim kvalifikacijama, radnom iskustvu, praćenim obukama, referencama i potvrdom od suda da lice nije pod istragom, itd. mogu se dostaviti:

- Direktno u Kancelariji za Ljudske Resurse MIP-a i,
- Preko pošte.

Dostavljene prijave za konkurs nakon isteka roka, one ne kompletirane i pogrešno popunjene, smatraće se nevažećim i neće biti uzete u obzir.

Kandidati trebaju dostaviti prijave za konkurs sa tačnim podacima. U slučaju neispunjavanja ovih zahteva, ili u slučaju pružanja netačnih informacija, prijava se odbija. Takođe, korišćenje neslužbenih obrazaca rezultira sa neposrednim odbijanjem prijave za konkurs.

Primljene aplikacije nakon određenog roka, smatraju se prihvatljivim ako datum na poštanskoj dostavi, ili bilo koji drugi dokaz o datumu pošiljke, dokazuje da je poslato pre isteka roka za dostavljanje prijava za konkurs.

Vremenski rok imenovanja – zaposlenja, vrši se u skladu sa ZCSK-om, u kojoj je obuhvaćen period probnog rada od jedne (1) godine.

Jedino kandidati koji budu izabrani u užu spisak će biti kontaktirani.

Konkurs ostaje otvoren 15. dana nakon registracije i objavljivanja i biće otvoren od 17.04.2018 god. do 01.05.2018 god. U 16:00 časova.

Za dodatne informacije možete kontaktirati Kancelariju za ljudske resurse MIP-a, na brojevima telefona: 038 213 998 i 038 212 366.

Konkurs i zahtev za zapošljavanje su objavljeni na veb stranici ministarstva: [www.mfa-ks.net](http://www.mfa-ks.net) „Civilna Služba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve državljane Kosova i pozdravlja prijave od muških i ženskih polova kao i od svih zajednica Kosova“;

“Ne-većinske zajednice i njeni pripadnici imaju pravo proporcijalnog i pravog predstavljanja u organima civilne službe u javnoj administraciji centralnog i lokalnog nivoa, kao što je određeno u članu 11. stav 3. Zakona br. 03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosovo“;

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se “BEAUTY ACADEMY”, SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: Nrb. Biznesit 71237834 dhe nr.fiskal: 601572383 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “BEAUTY ACADEMY” d.o.o. od Pristina, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : NRB. Biznesit: 71237834 i broj fiskala: 601572383 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the “BEAUTY ACADEMY”, L.L.C. in Prishtina, has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit: 71237834, i number fiskal: 601572383 The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
OSNOVNI SUD MITROVICA - BASIC COURT OF MITROVICA

---

**GJYKATA THEMELORE**  
C.nr.727/2017  
Me dt.13.04.2018  
Mitrovicë

**PRISHTINË**

Ne bazë të artikullit 43 të Ligjit mbi procedurën kontestimore të Kosovës lidhur me të publikimi KBE,

**SHPALLJE**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, në qelbëtim juridike të palitshme: Mahamer Uka me vendimim të Mitrovicës të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Av. Besim Miftari nga Mitrovica, kundër të paditurës: Mirëza Uka me mbështetëse vajzaria Konushveci, Feh. Ljajq, Komuna e Istogut tani me vendimim të panjohur në Beotit e Jashitit, për shkak të zgjidhjes së martesës, në bazë të artikullit 79 pika 3-a e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore të Kosovës të paditurës: Mirëza Uka i caktuar përfaqësojë e përfaqësojë Fazir Ahmeti - Avokate nga Mitrovica.

Përfaqësojë e Përfaqësojë do të përfaqësojë të paditurës në këtë qelbëtim juridike deri sa ajo apo autorizimja e saj të paraqiten në këtë Gjykatë.

**GJYQTARI**  
Rajiq Kadriu



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government



Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)  
Univerziteteske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)  
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)  
Qendra Klinike Universitare e Kosovës - Univerziteti Kliniçi Centar Kosova University  
Clinical Center of Kosovo  
Sektori i Personelit

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit të 4 Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, dhe nenit 6 pika 1.1 dhe nenit 13 pika 1 dhe 3 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar të Kosovës, (SHSKUK), nenit 12 si dhe neni 13 pika 1 dhe neni 15 të Statutit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, shkresa elektronike e datës 05.04.2018, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK shpallë:

## KONKURS

Institucioni: Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)  
Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK)

Nr	Mjekë Specialistë	Klinika-repartit	Janë kërkuar:
1.	Mjekë Specialistë- Peditër	Klinika e Peditrisë Intensive	1
2.	Mjekë Specialistë - Peditër	Klinika e Peditrisë Hematoonkologji	1
3.	Mjekë Specialistë – Kirurg	Klinika e Kirurgjisë Abdominale	2
4.	Mjekë Specialistë -Kirurg	Klinika e Kirurgjisë Torakale	1
5.	Mjekë Specialistë -Kirurg	Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve	1
6.	Mjekë Specialistë -Kardiolog	Shërbimi klinik i Emergjencës	3
7.	Mjekë Specialistë -Mjeksi Interne	Shërbimi klinik i Emergjencës	3
8.	Mjekë Specialistë -Anesteziolog	Klinika e Anestezionit dhe Mjekimi Intenziv	5
9.	Mjekë Specialistë -Mjeksi Interne	Klinika e Anestezionit dhe Mjekimi Intenziv	2
10.	Mjekë Specialistë -Ortoped	Klinika e Ortopedisë dhe Traumatologjisë Lokomotore	1
11.	Mjekë Specialistë -Neurolog	Klinika e Neurologjisë	2

**Koeficienti i pagës:** (8.4)  
**Norma e punës:** Orar i plotë (40 orë në javë)  
**Kontrata:** Sipas legjislacionit në fuqi  
**Raporton:** Shefit të Repartit të Klinikës Përkatëse  
**Nr. i Referencës:** QKUK – 15/2018-04/22

### Qëllimi kryesor i vendit të punës:

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor e sasior bazuar në nivelin profesional që ka

### Përgjegjësit kryesore të mjekut specialist:

- Bashkë me Shefin e repartit dhe stafin tjetër drejtues menaxhon me resurset humane, pajisjet, objektet e inventarin për nivelin të cilit i takon.
- Siguron standarde të larta të përkujdesjes ndaj pacienteve.
- Mirësjellja, kujdesi dhe respektimi i pacientit dhe personelit punues.
- Mirësjellja dhe bashkëpunimi profesional me stafin tjetër punues.
- Pranimi, ekzaminimi e trajtimi përkatës i pacientit.
- Kryen evidentimin e rregullt përmes dokumentacionit mjekësor (historia e sëmundjes, fletëshimi, protokollit etj) të pacientit.
- Kryen vizitat e rregullta tek pacientët e shtrirë në institucionin shëndetësor.
- Bënë kërkesa për vizita plotësuese-konsultative,
- Mbikëqyrë realizimin e detyrave ditorë të punës të stafit punues.
- Jep mendime profesionale për punën që kryen.
- Kryen detyra të tjera ashtu si kërkon mbikëqyrësi për mbarëvajtjen e punëve në institucionin ku është i punësuar.
- Kryen edhe detyra të veçanta kur i kërkohen lidhur me profesionin e ngushtë specialistik që e ka.
- Është përgjegjës për hartimin e plan-programit të punës së tij individuale e kolektive në vendin e punës,
- Angazhon stafin punues në realizimin e detyrave ditore të punës,
- Siguron dhe zhvillon programe e kurse trajnimi profesional,
- Bën kontrollin e rregullt (inspektimin e hapësirave, pajisjeve dhe të inventarit në vendin e punës).
- Siguron ambient të pastër e të sigurt për të gjithë,
- Menaxhon me material shpenzues dhe pajisjet tjera,
- Siguron sistem efikas komunikimi për të gjithë brenda institucionit,
- Përpunon dhe realizon protokole profesionale të trajtimit të pacienteve,
- Merr pjesë në studime kërkimore-shkencore profesionale,
- Ndërmerr masa për ngritjen e cilësive menaxhuese të aftësitë profesionale dhe kolektiv në repart(njësi),
- Ushtron detyra plotësuese bazuar në kualifikimin e tij profesional dhe menaxhuese etj,
- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor bazuar në nivelin profesional që ka,
